



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 1 Akti

Nr. 17 Vendimi

Tiranë, më 04.06.2018

V E N D I M

Trupa gjyqese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e përbërë nga:

Etleda Çiftja
Brunilda Bekteshi
Genta Tafa (Bungo)

Kryesuese
Relatore
Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore Znj. Anisa Duka, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, Z. Branko Hrvatin, sot, më datë 3 maj 2018, ora 15:00, pranë Pallatit të Kongreseve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Znj. Altina Xhoxhaj, gjyqtare pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar me deklaram nga Znj. Adriana Shehi (Kalo), avokate e Dhomës së Avokatisë Tiranë, me nr. licence 984.

OBJEKTI :

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE :

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, Znj. Brunilda Bekteshi, subjektin e rivlerësimit dhe përfaqësuesin e saj, avokaten Adriana Shehi (Kalo), vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi dhe bisedoi në tërësi çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit Altina Xhoxhaj, e cila në seancën dëgjimore publike të datës 23.04.2018 kërkoi konfirmimin e saj në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Altina S. Xhoxhaj është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese. Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (këtu e në vijim referuar “Ligji nr. 84/2016”), parashikojnë se: *“Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit ex officio”*. Në bazë të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si dhe Rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit” në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit” (këtu e në vijim referuar “Komisioni”), duke qenë se Znj. Altina Xhoxhaj është gjyqtare pranë Gjykatës Kushtetuese, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar më datë 6 nëntor 2017, me trupë gjyquese nr. 2, të përbërë nga:

Genta Tafa	Komisionere;
Brunilda Bekteshi	Relatore;
Etleda Çiftja	Komisionere.

2. Pas hedhjes së shortit, trupa gjyquese administroi:
 - Raportin e vlerësimit të pasurisë sipas neneve 31- 33 të ligjit nr. 84/2016, të hartuar nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (këtu e në vijim referuar “ILDKPKI”);

- Raportin e vlerësimit të figurës sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (këtu e në vijim referuar “DSIK”);
 - Raportin e vlerësimit profesional sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (këtu e në vijim referuar “KLD”).
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 1, datë 14.11.2017, të trupës gjyquese nr. 2, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, për të tri kriteret, bazuar në pikën 1 të nenit 4 të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesuesi i trupës gjyquese, Znj. Etleda Çiftja. Anëtarët e trupës gjyquese deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
 4. Më datë 16.03.2018, trupa gjyquese nr. 2, me anë të vendimit nr. 2 vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, Znj. Altina Xhoxhaj, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, në bazë të paragrafit 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.
 5. Më datë 19.03.2018, trupa gjyquese njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 për të sjellë prova për të provuar të kundërtën nëse disponon, brenda 20 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike; (iii) për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, duke paraqitur kërkesë për njohjen me dosjen brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike; (iv) përbërjen e trupës gjyquese.
 6. Më datë 21.03.2018, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesën nr. 2676 prot., për t’u njohur me dosjen. Subjekti i rivlerësimit kërkoi metodikën e përdorur lidhur me përlllogaritjet e shpenzimeve për udhëtimet e subjektit dhe personit të lidhur. Subjektit, po në këtë datë, me anë të postës elektronike iu komunikua se metodika është pjesë e dosjes.
 7. Më datë 30.03.2018, subjekti i rivlerësimit, përmes postës elektronike kërkoi vënien në dispozicion të metodikës së përdorur mbi llogaritjet e kryera nga ekspertët e Komisionit për pjesën e likuiditeteve për vitet 2007, 2009 dhe 2015, e cila iu dërgua me anë të postës elektronike.
 8. Më datë 07.04.2018, subjekti i rivlerësimit dërgoi shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit kryesisht.
 9. Më datë 17.04.2018, trupa gjyquese nr. 2, me anë të vendimit nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, Znj. Altina Xhoxhaj, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Dhe me anë të postës elektronike, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më datë 23.04.2018, ora 11:00 paradite, në Pallatin e Kongreseve, kati i 2-të, Tiranë.

10. Më datë 23.04 2018 u zhvillua seanca dëgjimore ku subjekti i rivlerësimit ishte prezent, bashkë me përfaqësuesen ligjore, Znj. Adriana Shehi. Trupa gjyquese ndërpreu seancën dëgjimore për të rifilluar më datë 25.04.2018 për shpallje vendimi.
11. Më datë 25.04.2018, seanca dëgjimore rifilloi dhe Komisioni shtyu seancën për shpalljen e vendimit më datë 3 maj 2018, për të kryer dhe një herë llogaritjet e likuiditeteve, bazuar në pretendimet e subjektit të rivlerësimit ditën e seancës dëgjimore.

II. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në Deklaratën për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja; (c) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja, (d) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga KLD-ja, (e) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (ë) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (f) denoncimet nga publiku; (g) faktet e njohura botërisht.

Në referim të dispozitave ligjore kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioni në mënyrë të pavarur dhe të paanshme ka kryer një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse, siç përcaktohet edhe në vendimet e Gjykatës Kushtetuese, Nr. 2 dhe Nr. 78, të vitit 2017.

Komisioni, gjatë hetimit të çështjes administroi:

- dokumente të tjera shkresore, përveç atyre që ka administruar ILDKPKI-ja, nga organet publike në përputhje me nenin 50 të ligjit nr. 84/2016;
- deklarata, përgjigje të dhëna nga ana e subjektit të rivlerësimit;
- 2 denoncime nga publiku, ndërkohë që:
- nuk u paraqit ndonjë gjetje në formën e një deklarate, dokumenti ose raporti nga vëzhguesi ndërkombëtar, apo mendim me shkrim nga vëzhguesi ndërkombëtar.

A. RAPORTI I HOLLËSISHËM DHE I ARSYETUAR I INSPEKTORATIT TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

ILDKPKI-ja, me shkresën nr. *******, datë 06.01.2017, ka dërguar raportin e detajuar lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit sipas neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ka bërë analizimin e të dhënave të deklaruara nga subjekti me informacionet e ardhura nga institucionet e specializuara, nga i cili ka rezultuar se për subjektin e rivlerësimit, Altina Xhoxhaj:

1. deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
2. ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
3. nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
4. nuk ka kryer deklarim të rremë;
5. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

B. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, si dhe verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklaramëve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit kalimtar, Komisioni vlerësoi të zhvillojë hetim të thelluar sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, i cili u zhvillua në raport me:

- deklaratat e pasurisë së subjektit të rivlerësimit ndër vite;
- likuiditetet e deklaruara ndër vite;
- veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit me dhe për llogari të personave të lidhur e të tjerë, bashkëjetuesi, babai, nëna dhe motra;
- pasuri me burim krijimi në kuadër deklarativ të pashoqëruar me dokumentacion justifikues, sipas nenit 3, pika 19, të ligjit nr. 84/2016.

Nga shqyrtimi i provave të administruara nga Komisioni, për secilin nga asetet dhe të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, konstatohet se:

1. Në lidhje me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 101 m², Rr. “***”, nd. ***, h***, ap. ***, Tiranë. Pjesa takuese/zotëruese 50%. Fituar me anë të kontratës së sipërmarrjes datë 8 mars 2005, me çmimin 61.050 euro, shlyer 50.000 euro më datë 8 mars 2005 dhe 10.050 euro më datë 8 gusht 2005 nga bashkëjetuesi A.I. 100 %. Regjistruar në ZVRPP më 16.12.2011, sipas kontratës së shitjes nr. *** rep. dhe *** kol., datë 07.12.2011, me 50 % secili.

Me burim të deklaruar të krijimit: Të ardhurat nga puna dhe bursat e personit të lidhur/bashkëjetuesit, në Itali, nga viti 1992 deri në vitin 2001.

1.1. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave kërkoi dhe administroi nga institucionet:

- ✓ Shkresë nr. ***prot., datë 30.11.2017, drejtuar ILDKPKI-së.
- Me shkresën nr. ***prot., datë 05.12.2017, ILDKPKI-ja ka informuar lidhur mbi kërkimin e bërë¹.
- ✓ Shkresë nr. *** prot., datë 11.12.2017, drejtuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (këtu e në vijim referuar ZVRPP) Tiranë.
- Me shkresën nr. *** prot., datë 20.12.2017, ZVRPP Tiranë informon se Znj. Altina Xhoxhaj dhe Z. A.I. figurojnë bashkëpronarë në pasurinë nr. ***, volum ***, faqe ***, ZK ***, lloji pasuri apartament, me sipërfaqe 101 m². Bashkëngjitur, ky institucion ka përcjellë edhe praktikën shoqëruese. Dokumentacioni i kësaj pasurie ka të administruar kontratën e shitjes midis dy subjekteve (subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëjetuesi) dhe shoqërisë “***” sh.p.k., nr. *** rep., *** kol., datë 07.12.2011²,

¹ Shtetasi A.B.I i datëlindjes ***, person i lidhur i subjektit të rivlerësimit, Altina S. Xhoxhaj, ka qenë subjekt deklarues sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, deri në vitin 2014. ILDKPKI ka dërguar të gjitha deklaramimet e interesave private ndër vite.

² Në kontratë është pasqyruar “Palët deklarojnë se me vlerën e shitblerjes janë likuiduar jashtë kësaj zyre, sipas kësteve të përcaktuara në kontratën e porosisë, të datës 5 mars 2005 dhe nuk kanë asnjë pretendim ndaj njëri-tjetrit”.

por nuk ka të administruar kontratën e sipërmarrjes dhe faturat mbi derdhjen e shumës me të cilën është blerë apartamenti, objekt shqyrtimi.

- ✓ Shkresë nr. ***, datë 04.01.2018, drejtuar shoqërisë “***” sh.p.k.
- ✓ Shkresë nr. *** prot., datë 15.01.2018 drejtuar shoqërisë “***” sh.p.k.
- Shoqëria “***” sh.p.k. ka depozituar kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep. Dhe *** kol., datë 07.12.2011, lidhur midis saj dhe dy shtetasve, subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur/bashkëjetuesit, pavarësisht kërkimit të Komisionit për depozitim të çdo kontrate nëse administronin të tilla.
- ✓ Shkresë nr. *** prot., datë 05.12.2017, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (këtu e në vijim DPPPP), për informacion lidhur me depozita, llogari, transaksione të kryera etj., nga momenti i hapjes së tyre dhe deri aktualisht, pranë institucioneve bankare jashtë vendit, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.
- DPPPP dërgoi informacion konfidencial lidhur me llogaritë bankare në shtetin italian.
- ✓ Me anë të postës elektronike, datë 27.02.2018, iu kërkua noterit publik, Znj. L.K, mundësimi i akteve që shoqërojnë aktin/deklaratën noteriale nr. *** rep., *** kol., datë 07.03.2005, në emër të shtetasit A.B.I.
- Noteri, më datë 1.03.2018, vë në dispozicion kontratën e sipërmarrjes, nr. *** rep., *** kol., datë 07.03.2005, “Për kalimin e pasurisë”.
- ✓ Më datë 05.03.2018 iu kërkua subjektit të rivlerësimit të deklarojë lidhur me dy kontratat e sipërmarrjes, nr. *** rep., *** kol., datë 31.03.2003, për blerjen e pasurisë dhe nr. *** rep., *** kol., datë 07.03.2005, “Mbi kalimin e pasurisë të shtetasi I.H”, për të cilat subjekti i rivlerësimit ka dhënë deklaratimet e saj.

1.2 Komisioni, me vendimin nr. 2, datë 16.03.2018, të trupës gjyquese nr. 2 vendosi të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit dhe, më datë 19.03.2018, njoftoi subjektin e rivlerësimit se mund të njihet me dokumentet e dosjes dhe se Komisioni ka arritur në përfundimin se provat e administruara në lidhje me këtë pasuri kanë nivelin e provueshmërisë, duke i dërguar subjektit të rivlerësimit rezultatet e hetimit kryesisht, duke njoftuar subjektin se i ka kaluar barra e provës për të provuar të kundërtën, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa më poshtë rezulton:

- a. *Ka mospërputhje sa u takon deklaratimeve për burimin e të ardhurave midis deklaratës së interesave private të personit të lidhur në vitin 2005, Deklaratës së Pasurisë “Vetting” dhe origjinës së krijimit të kësaj pasurie, kontrata e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.03.2003.*
- b. *Ka mungesë dokumentacioni ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për blerjen e apartamentit referuar Deklaratës “Vetting”, për sa më poshtë:*

Në Deklaratën “Vetting” keni deklaruar se kjo pasuri e ka burimin e të ardhurave “Nga puna dhe bursat e personit të lidhur/bashkëjetuesit, në Itali, nga viti 1992 deri në 2001”.

Në tabelën e mëposhtme janë të reflektuara të ardhurat e krijuara për të justifikuar këtë pasuri sipas dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit (i bazuar në kreditimet e llogarive bankare).

Periudha	Të ardhura në lireta sipas dokumentacionit të ligjshëm depozituar (I)	Të ardhura në lekë me dokumentacion (II)	Shpenzime ³ në euro, sipas ISTAT, Itali (III)	Shpenzime në lekë (IV)
Shtator-Dhjetor 1992_Bursa	4 436 000	260 482	1 720	229 878 ⁴
Janar-Dhjetor 1993_Bursa	12 120 000	711 686	5 160	689 634
Janar-Dhjetor 1994_Bursa	14 400 000	845 568	5 280	705 672
Janar-Dhjetor 1995_Bursa			5 400	721 710 ⁵
1996			5 400	721 710 ⁶
1997	3 200 000	279 552	5 520	737 748 ⁷
1998			5 760	769 824 ⁸
1999			6 000	801 900 ⁹
2000	2 676 000	157 135	6 600	882 090 ¹⁰
2001	734 000	43 100	6 600	882 090
Total	37 566 000	2 297 523	53 440	7 142 256
Të ardhura – shpenzime (II-IV)		-4 844 733		

1.3 Subjekti i rivlerësimit, më datë 07.04.2018, dërgoi me anë të postës elektronike shpjegimet e saj¹¹ ku, ndër të tjera, për këtë pasuri është shprehur se:

- nuk i binte barra e provës për të provuar ligjshmërinë e fitimit të apartamentit, pasuri e deklaruar në Deklaratën “Vetting”, pasi apartamenti ishte shlyer nga personi i lidhur/bashkëjetuesi, i cili duke qenë subjekt i ligjit nr. 9049/2003, kishte deklaruar dhe dhënë sqarime që prej vitit 2003, lidhur me mënyrën e shlyerjes së apartamentit 1 + 1, si

³ Për shpenzimet e jetesës së personit të lidhur/bashkëjetuesi është marrë si referencë ISTAT-i, Itali (raporti titullohet: “Të dhënat e përditësuara për shpenzimet e konsumit për periudhën 2002-2004”). Kursi i këmbimit i përdorur për konvertimin është marrë nga kursi mesatar i Bankës së Shqipërisë për vitin përkatës.

⁴ Konvertuar në lekë me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të datës 31.12.1994 prej 58,72 lekë për 1,000 Lit për periudhën 1992-1994

⁵ Konvertuar në lekë me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të datës 31.12.1995 prej 57,22 lekë për 1,000 Lit

⁶ Konvertuar në lekë me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të datës 31.12.1996 prej 67,76 lekë për 1,000 Lit

⁷ Konvertuar në lekë me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të datës 31.12.1997 prej 87,78 lekë për 1,000 Lit

⁸ Konvertuar në lekë me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të datës 31.12.1998 prej 86,78 lekë për 1,000 Lit

⁹ Konvertuar në lekë me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të datës 31.12.1999 prej 75,90 lekë për 1,000 Lit

¹⁰ Konvertuar në lekë me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të datës 31.12.2000 prej 68,74 lekë për 1,000 Lit për periudhën 2000-2001

¹¹ Referojuni parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit në dosje.

dhe kur kishin kaluar të drejtat që kishte pasur mbi këtë apartament dhe kishte porositur apartamentin 2 + 1;

- kontributi kishte qenë plotësisht i personit të lidhur/bashkëjetuesit, dhe nuk kishte pasur arsye të mohonte kontributin, pasi kishte pasur të ardhura prej vitit 1992.

Ndërsa, në lidhje me burimin e të ardhurave të personit të lidhur/bashkëjetuesit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se:

- Ka pasur vështirësi në gjetjen e dokumentacionit, pasi periudha që personi i lidhur kishte punuar në Itali (prej 1992) i përkiste një kohe shumë të largët.
- Komisioni duhet t'i merrte në konsideratë provat e depozituara që në fillim të deklarimit "Vetting", pavarësisht se ato nuk ishin të plota apo edhe se marrëdhënia kontraktore e bashkëjetuesit me shoqërinë "***" s.r.l. kishte qenë njëvjeçare.
- Kontrata e punës me shoqërinë "***" s.r.l. duhet të merrej si provë e plotë që provon se marrëdhëniet e punës kishin qenë në vazhdimësi me të njëjtin subjekt deri në momentin kur kishte qenë dhe paga e fundit e marrë prej personit të lidhur në Itali.
- Të ardhurat kishin qenë të mjaftueshme me qëllim blerjen e pasurisë në vitin 2003 krejtësisht nga bashkëjetuesi.
- Paga minimale kishte qenë mesatarisht 1 100 000 lireta italiane në muaj, pa llogaritur këtu se gjatë sezoneve turistike kishte përfutur diferencë të paguar në "të zezë", duke fituar edhe mbi 2 000 000 lireta në muaj, si dhe për ushqime i ishin mbuluar nga punëdhënësi.
- Marrëdhënia e punës provohej edhe juridikisht nga listëpagesat e pagave mujore (ato që ishin vënë në dispozicion, si dokumentacion shoqëruar, gjithashtu dhe marrëdhëniet me bankën). Nuk kishte pasur mundësi të gjente dokumentacion shtesë në bankë, pasi informacioni i kërkuar kishte të bënte me një periudhë kohe të largët dhe nuk ishin ruajtur të dhënat për një person që nuk ishte më klient i bankës prej gati 20 vjetësh.
- Shpjegimet e saj dhe të personit të lidhur me dokumentacionin e ruajtur përbënin prova të besueshme në kuptim të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, por dhe provë të plotë në kuptim të neneve 246 e vijues të KPC-së.

Subjekti i rivlerësimit edhe në seancë dëgjimore u qëndroi parashtrimeve të depozituara pas kalimit të barrës së provës, si më lart cituam.

1.4 Arsytimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm:

Komisioni, mbështetur në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në Deklaratën e Pasurisë për Procesin e Rivlerësimit Kalimtar, "Vetting", në raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike, sipas pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, si dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, provat shkresore të administruara, sipas neneve 49 dhe 50 të po këtij ligji, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të postës elektronike, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe avokatja e saj për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, arsyeton se:

- ❖ Në lidhje me ligjshmërinë e burimit të deklaruar të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e këtij apartamenti, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, deklarim të rremë dhe fshehje të të ardhurave, provuar kjo me:
 - a. Deklarimin e subjektit të rivlerësimit në Deklaratën "Vetting", ku deklaronte se kjo pasuri e ka burimin e të ardhurave "Nga puna dhe bursat e personit të lidhur, në

- Itali, nga viti 1992 deri në 2001*”, ndërsa subjekti i lidhur/bashkëjetuesi, në Deklaratën “Vetting”, nuk e ka deklaruar burimin e të ardhurave të kësaj pasurie;
- b. Shkresën nr. *** prot., datë 10.05.2017, të DPPPP-së, me anë të së cilës është konfirmuar se mënyra e pagesës është bërë me këste, sipas kontratës së sipërmarrjes dhe burimi i të ardhurave është nga punësimi i tij dhe bashkëshortes”.
- c. Mospërputhjet midis deklarimeve në Deklaratën “Vetting”, atyre në deklaratën e vitit 2005 dhe deklarimeve të vitit 2003 në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, pasi në deklaratën e interesave private plotësuar nga personi i lidhur/bashkëjetuesi në vitin 2003 është deklaruar pasuri: *...shtëpi banimi, apartament 93 m², vlera 4.723 milionë lekë, blv. “***”, pallati i ri *** , kati i ***-të, pronësi e paregjistruar. Pjesa zotëruese 100%. Burimi i krijimit: 1.335 ml/lekë (pjesë) nga shitja e shtëpisë së banimit në Rr. “***” + 3.388 pjesë nga kursimet e 8 vjet pune në Itali “***” s.r.l.*”, ndërsa në deklaratën e interesave private plotësuar nga personi i lidhur/bashkëjetuesi në vitin 2005 (provë e administruar në dosje), pasuria-vetting është deklaruar: *“blerë apartament banimi sip. 111 m², copë 1, blv. “***”, pallati 9- katësh, pas *** , K. *** , 8 mars 2005 në shumën 61 050 euro (blerë me të ardhurat e shitjes + kursimet vjetore).”*. Në po të njëjtën deklaratë, deklarohet: *“shitur apartament banimi sip. 93 m², copë 1, blv. “***”, pallati në *** , K. *** (blerë 2003), 7 mars 2005, në shumën 56 000 euro. Pjesa në zotërim 100 %.”*. Më tej, në deklaratën e vitit 2005 të personit të lidhur/bashkëjetuesit, Komisioni konstatoi se për krijimin e pasurisë-vetting, objekt i hetimit administrativ, kishte një burim të ardhurash nga shitja e apartamentit më datë 7 mars 2005, ndryshe nga ç’ ishte deklaruar në burimin e krijimit të pasurisë në Deklaratën “Vetting”.
- d. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit me anë të postës elektronike në lidhje me mënyrën e fitimit të pronësisë së kësaj pasurie, si dhe dokumentacionin e depozituar për këtë qëllim. Subjekti i rivlerësimit është shprehur se: *“Deklarimi i vitit 2003 ishte bërë në përputhje me gjendjen faktike të asaj kohe. Nga sa ishte në dijeni nga personi i lidhur (bëhet fjalë për veprime që janë kryer 15 vjet përpara), apartamenti nuk kishte rezultuar në pronësi të personit të lidhur (me titull pronësie), por kishte qenë lidhur një kontratë sipërmarrjeje, ndoshta në vitin 2003, me shoqërinë “***”, së cilës (sipas mënyrës se si funksiononte tregu në Shqipëri në atë kohë) i ishte likuiduar shuma, pavarësisht faktit se asnjë e drejtë reale nuk kishte kaluar me këtë kontratë. Më tej, të drejtat reale të kësaj sipërmarrjeje kishin kaluar për llogari të një të treti në shumën 56 000 euro. Personi i lidhur kishte jetuar për një periudhë afërsisht 2-vjeçare në këtë apartament (ndërsa subjekti kishte shkuar të jetojë atje, me sa mban, nga fundi i vitit 2004 ose fillimi i vitit 2005).”*
Më tej, subjekti i rivlerësimit depozitoi edhe përgjigjen e dhënë nga personi i lidhur/bashkëjetuesi, Z. A.I, i cili ndër të tjera ka sqaruar se: *“...në kushtet kur që prej datës 7 mars 2005 nuk gëzonte asnjë lloj të drejte mbi apartamentin në fjalë (pasi kishte hequr dorë nga porosia edhe pse kishte likuiduar totalisht çmimin e kërkuar nga firma), kishte ruajtur vetëm dokumentacionin që provonte burimin e të ardhurave nga puna në Itali (jo për efekt prove mbi këtë veprim, po për efekt të kërkimit të pensionit pranë autoritetit italian)... Deklarata noteriale e datës 7 mars 2005 ishte hartuar me kërkesë të personit tek i cili kishin kaluar të drejtat e porositësit, kuptohet me çmimin e ri të imponuar nga tregu, për ta pasur atë si provë*

që kishte paguar shumën e plotë të rënë dakord. Në deklaratën në fjalë citohet edhe kontrata e sipërmarrjes për kalimin e të drejtave të porositësi i ri për apartamentin në fjalë, kontratë që, me sa mbante mend, ishte lidhur midis shoqërisë së ndërtimit, atij dhe personit që i kishin kaluar të drejtat...”.

- e. Dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, deklaratën noteriale nr. 480 rep., 67 kol., datë 7.03.2005, për kalimin e pasurisë të shtetasi I.H, në përmbajtje të së cilës u konstatua se ekzistonte një kontratë sipërmarrjeje me nr. *** rep., *** kol., datë 7.03.2005, e noterit publik, Znj. L.K, akt i cili paraprakisht iu kërkua subjektit të rivlerësimit me anë të postës elektronike. Komisioni hetoi dhe e siguroi atë pranë noterit publik, Znj. L.K, e cila vuri në dispozicion kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., *** kol., datë 07.03.2005.

Në këtë kontratë u konstatua se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëjetuesi, me vullnet të lirë e të plotë, pa cilësuar pjesë të ndryshme takuese apo raporte të ndryshme kontributesh, kishin rënë dakord në prani të shoqërisë ndërtimore “***” sh.p.k., që apartamentin me sipërfaqe 93 m², të ndodhur në katin e tetë, ta kalojnë në emër të Z. I.H, i cili kishte likuiduar shumën e plotë për blerjen e tij prej 56 000 eurosh. Në po të njëjtën kontratë pasqyrohet se Z. A.I dhe Znj. Altina Xhoxhaj morën në dorëzim shumën për shitjen e apartamentit dhe se nuk kanë asnjë të drejtë pronësie mbi këtë apartament. Ndërsa në lidhje me origjinën e pasurisë që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur ia kaluan shtetasit I.H, në po të njëjtën kontratë, citohet se: “*Shoqëria e ndërtimit, më datë 31.03.2003, ka lidhur një kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., *** kol., me Z. A.I dhe Znj. Altina Xhoxhaj, për një apartament të ndodhur në Tiranë, blv. “***”, në një kompleks biznes – banim – parking, sipas lejes së ndërtimit 792, datë 22.12.1998. Sipërfaqja e ambientit është 93 m², në katin *** të banimit. Për blerjen e këtij apartamenti është paguar nga Z. A.I dhe Znj. Altina Xhoxhaj shuma 41 850 dollarë amerikanë.*”

Në këto kushte, Komisioni, bazuar në aktet noteriale të cituara më lart, vëren se apartamenti i kaluar në favor të shtetasit I.H. në vitin 2005, është blerë njëkohësisht nga të dy subjektet (subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/ bashkëjetuesi) në vitin 2003 nëpërmjet kontratës nr. *** rep., *** kol, datë 31.03.2003. Veprimet e Komisionit për të administruar kontratat si burimi kryesor i krijimit të pasurisë-vetting, janë legjitime, për shkak se vetë palët kanë hyrë në marrëdhënie kontraktore me vullnet të lirë, duke përcaktuar edhe vlerat e dhëna/marra për blerjen dhe shitjen e saj.

Pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se në vitin 2003 nuk ka qenë në kushtet e bashkëjetesës, nuk e përjashton atë nga detyrimi për të deklaruar kontratën në të cilën ka qenë palë, pasi ajo ka fituar të drejta mbi një pronësi, si dhe ka kryer pagesa në lidhje me këtë pasuri. Edhe pse subjekti i rivlerësimit pretendon se në vitin 2003 nuk ka qenë në kushtet e bashkëjetesës, Z. A.I konsiderohej person i lidhur sipas pikës 4 të nenit 2 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar¹², ku citohet se : “*Persona të lidhur*” janë të gjithë personat, fizikë ose juridikë, të cilët, nga kërkimet administrative, rezultojnë të kenë pasur ose të kenë lidhje pasurore me personin që mbart detyrimin për deklarim, në njërën nga format e përcaktuara në këtë ligj.”. Fakti i blerjes së pasurisë (në vitin 2003), i kalimit të saj (në vitin 2005), nga të dy subjektet (subjekti i rivlerësimit dhe personi i

¹² Ky ligj aplikohet për shkak të kohës në të cilën ka ndodhur veprimi, konkretisht nënshkrimi i kontratës në vitin 2003 dhe 2005 nga të dy subjektet.

lidhur/bashkëjetuesi), i përcaktimit të shumave përkatëse të blerjes dhe shitjes së pasurisë, tregon qartazi pozicionin e subjektit të rivlerësimit në raport me këtë pasuri dhe, për pasojë, në pasurinë-vetting. Provueshmëria e subjektit të rivlerësimit mbeti në nivele deklarative.

Nga ana tjetër, deklarimi i subjektit të rivlerësimit se deklarata noteriale e marrjes së shumës së shitjes së apartamentit në vitin 2005 është provë që tregon se pronësia është blerë e shitur prej personit të lidhur, nuk qëndron për vetë faktin se në raport me kontratën, kjo e fundit konkurren, por edhe se deklarata thjesht dhe vetëm ka rikonfirmuar vullnetin e shprehur në kontratë. Veprimet noteriale të pasurisë që ka shërbyer si burim krijimi i pasurisë-vetting janë formalizuar me kontrata sipërmarrjeje, por që në thelb kanë pasur qëllim “blerje” e “shitje” të pasurisë. Pasuria-vetting e ka burimin nga kontrata nr. *** rep., *** kol., datë 31 mars 2003, sipas të cilës subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi A.I. kanë blerë apartamentin në shumën 41 850 dollarë.

Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk ka pasur të drejta reale mbi pronësinë e shitur, Komisioni çmon se ky pretendim bie në kundërshtim me vetë aktin noterial të vitit 2005, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit nuk mund t'i kalonte një të drejtë reale që ajo vetë nuk e kishte. Po kështu, nuk qëndron edhe deklarimi i bërë nga personi i lidhur/bashkëjetuesi se “me sa mban mend ai, kontrata e kalimit të të drejtave reale të pasurisë është lidhur midis shoqërisë së ndërtimit, vetë personit të lidhur dhe atij që i kanë kaluar të drejtat e pronësisë”, pasi rezultoi e provuar se kontrata për kalimin e pasurisë është nënshkruar edhe nga subjekti i rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit nuk ka ndjekur parimin e sigurisë në vazhdimësi të deklarimit të pasurisë prej vitit 2003, tjetërsimit të saj në vitin 2005 e deri në deklarimin në Deklaratën “Vetting”. Provat ligjore (kontratat), nuk mbështesin pretendimin e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore se, përfshirja e saj në këtë pasuri, në vitin 2011, kohë në të cilën është formalizuar kontrata e shitjes së pasurisë-vetting, ka qenë vendim apo dëshirë e personit të lidhur.

Fshehja e veprimeve noteriale, nga ana e subjektit të rivlerësimit pasqyron mosdeklarimin me vërtetësi të burimit të krijimit të pasurisë-vetting. Pavarësisht se palët e kanë përcaktuar kontratën e datës 7 mars 2005 si kontratë sipërmarrjeje, ajo kryesisht ka elemente të kontratës së shitjes (me kusht). Qëllimi i vërtetë i subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të ka qenë shitja e apartamentit në shumën 56 000 euro dhe qëllimi i palës tjetër, personit të tretë, ka qenë blerja e apartamentit, referuar kjo edhe në nenin 681 të Kodit Civil, ku theksohet se: *“Kur interpretohet një kontratë, duhet që të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para e pas përfundimit të kontratës, duke u bazuar në objektin, si dhe detyrimet e marra përsipër”*. Ndërsa në nenin 659 të Kodit Civil parashikohet se *“Kontrata nuk është gjë tjetër, veçse një veprim juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike”*.

Në këtë kuptim, që kontrata e tjetërsimit të pasurive të paluajtshme, si veprim juridik, të jetë e vlefshme është e domosdoshme, përveç sa parashikohet në nenin 79 të Kodit Civil, të plotësohen dhe kushtet e parashikuara në nenin 663 të Kodit Civil dhe konkretisht, pëlqimi i palëve, përveç se shkak i ligjshëm, objekti i kontratës të jetë i përcaktuar dhe i ligjshëm, si dhe forma e kërkuar ligjore. Në këtë rast, kontrata e kalimit të të drejtave reale të pronësisë i pasqyron të gjitha këto elemente.

Sipas Kolegjit të Bashkuar të Gjykatës së Lartë, në funksion të unifikimit të praktikës gjyqësore,

me Vendimin nr. 1, datë 06.01.2009, citohet: “...Pronësia mbi një pasuri të paluajtshme kalon në çastin e lidhjes së kontratës së tjetërsimit të kësaj pasurie. Blerësi ose përfituesi i kësaj pasurie bëhet pronar i ligjshëm i saj që në momentin e nënshkrimit të kontratës, duke fituar dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me qenien e tij si pronar mbi këtë pasuri... Kontrata si veprim juridik i dyanshëm, në rast se plotëson kushtet për vlefshmërinë e saj edhe në rast se nuk regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme, është plotësisht e vlefshme mes palëve që e kanë realizuar atë. Është kontrata ajo që transferon mes palëve pronësinë e sendit të paluajtshëm, krijon të drejta reale mbi sendin dhe legjitimon pronarin të kërkojë dhe mbrojë këto të drejta.”.

Megjithëse subjektit të rivlerësimit iu kërkua që të provonte të kundërtën e rezultateve të Komisionit mbi fshehjen, në kuptim të pikës 5 të nenit D të Kushtetutës, ku parashikohet shprehimisht: “Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.”, ajo nuk solli asnjë provë, e cila kundërshtonte rezultatet e hetimit të Komisionit.

Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të kontribuar në blerjen e pasurisë, pasi ka punuar prej vitit 1994, Komisioni, pas njohjes dhe analizimit të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe deklarimeve të babait të saj, konstatoi se në deklaratën e vitit 2003 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme së bashku me anëtarët e familjes (sipas certifikatës së trungut familjar, subjekti i rivlerësimit, babai, nëna dhe motra e saj), duke përcaktuar edhe pjesën e saj takuese në secilën pronësi në ¼. Po në vitin 2003, deklarohen 2 milionë lekë kursime familjare “në përdorim për ndërtimin e banesës në ***”, dhe 35 000 dollarë me burim krijimi nga shitja e apartamentit të përfituar nga privatizimi i banesave shtetërore. Në vitin 2004, babai i subjektit ka deklaruar vlerën 35 000 dollarë, “të përdorur për përfundimin e banesës”, si dhe marrjen e një huaje nga një shtetas në shumën 1 000 000 lekë. Ndërkohë që, po në të njëjtin vit (2004), subjekti i rivlerësimit dhe babai i saj kanë deklaruar përfundimin e “banesës në ***”, në vlerën 8 500 000 lekë, në ndryshim nga viti 2003, vit kur kanë deklaruar ndërtimin e kësaj banese (karabina) në vlerën 3 000 000 lekë. Gjithashtu, në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit dhe babai i saj kanë aplikuar dhe përfituar edhe kredi në shumën 40 000 dollarë për blerje apartamenti, për shlyerjen e së cilës kanë marrë një tjetër kredi në shumën 10 000 euro, si dhe një hua në vlerën 4 000 euro. Në vitin 2005, babai i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar se vajza e tij (A.Xh.), motra e subjektit të rivlerësimit, ka marrë një hua në shumën 10 000 euro për babain, me qëllim blerjen e një apartamenti.

Pra, në lidhje me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, për burimin e të ardhurave nga puna nga viti 1994, Komisionit nuk i rezulton që subjekti të ketë pasur të ardhura të mjaftueshme për të blerë këtë pasuri, pasi vitet 2003 dhe 2004 janë karakterizuar nga marrje huaje dhe kredie. Kjo provohet bazuar edhe në përlllogaritjet financiare në vitin 2003, krahasuar edhe me kronologjinë e vijuar më pas, në 2004, sipas provave dhe argumenteve të dhëna më lart.

Më konkretisht, në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit rezulton me të ardhura nga paga në vlerën 644 678 lekë dhe nga përfitimi i shitjes së apartamentit, pasuri nga privatizimi i banesave shtetërore, në 1/5-tën pjesë takuese në vlerën 300 000 lekë. Duke zbritur shpenzimet mesatare për konsum në vlerën 160 714 lekë, rezulton se subjekti i rivlerësimit në fund të vitit 2003 ka pasur gjendje likuiditetesh në vlerën 783 964 lekë. Ndërsa në vitin 2004, subjekti i rivlerësimit rezulton

me të ardhura nga paga në vlerën 575 975 lekë. Duke zbritur shpenzimet mesatare për konsum në vlerën 160 714 lekë, rezulton se subjekti i rivlerësimit në fund të vitit 2004 ka pasur gjendje likuiditetesh në vlerën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë.

Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se burimi i krijimit të të ardhurave të kësaj pasurie është puna e personit të lidhur/bashkëjetuesit në Itali, si dhe bursat e përfituara prej tij, Komisioni konstaton se totali i të ardhurave të ligjshme, -sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit D të Kushtetutës, ku parashikohet shprehimisht: *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore...”*, -është në shumën 37 566 000 lireta (konvertuar në lekë me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë, sipas viteve respektive, në vlerën 2 297 523), ndërsa shpenzimet janë në shumën 53 440 euro (konvertuar në lekë me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë, sipas viteve respektive, në vlerën 7 142, 256). Diferenca midis të ardhurave të përftuara nga personi i lidhur, sipas dokumentacionit të depozituar, dhe shpenzimeve për jetesë, rezulton të jetë - 4 844 733 (katër milionë e tetëqind e dyzet e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre) lekë.

Për sa më lart argumentohet, Komisioni kreu analizën financiare të të ardhurave burim krijimi edhe në nivel deklarativ. Nga përlllogaritjet financiare, Komisioni konstaton se subjektit të lidhur i mbeten 206 399 (dyqind e gjashtë mijë e treqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë të ardhura neto nga puna e kryer në shtetin italian, çka provon mungesën e burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë.

Në tabelën e mëposhtme janë të pasqyruara të ardhurat e krijuara për të justifikuar këtë pasuri, sipas dokumentacionit të depozituar (i bazuar në kreditimet e llogarive bankare), sipas deklarimeve të subjektit, ku në të dyja rastet janë përlllogaritur edhe shpenzimet e jetesës së personit të lidhur/bashkëjetuesit në Itali.

Periodha	Të ardhura në lireta me dokumentacion	Të ardhura në lekë me dokumentacion	Shpenzime ¹³ në euro sipas ISTAT, Itali	Shpenzime në lekë	Të ardhurat në lireta në nivel deklarimi	Të ardhura në lekë sipas deklarimit
Shtator-Dhjetor 1992_Bursa	4 436 000	260 482	1 720	229 878	4 436 000	260 481
Janar-Dhjetor 1993_Bursa	12 120 000	711 686	5 160	689 634	12 000 000	711 686
Janar-Dhjetor 1994_Bursa	14 400 000	845 568	5 280	705 672	14 400 000	845 568
Janar-Dhjetor 1995_Bursa			5 400	721 710	7 200 000	422 784
1996			5 400	721 710		

¹³ Për shpenzimet e jetesës së subjektit të lidhur është marrë si referencë ISTAT, Itali (raporti titullohet: *“Të dhënat e përditësuara për shpenzimet e konsumit për periudhën 2002-2004”*). Kursi i këmbimit i përdorur për konvertimin marrë nga kursi mesatar i Bankës së Shqipërisë për vitin përkatës.

1997	3 200 000	279 552	5 520	737 748	13 200 000	1 153 152
1998			5 760	769 824	13 200 000	1 145 496
1999			6 000	801 900	13 200 000	1 001 880
2000	2 676 000	157 135	6 600	882 090	13 200 000	903 804
2001	734 000	43 100	6 600	882 090	13 200 000	903 804
Total	37 566 000	2 297 523	53 440	7 142 256	104 036 000	7 348 655
Të ardhura – shpenzime	-4 844 733				206 399	

Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit për krijimin e të ardhurave nga punësimi i personit të lidhur/bashkëjetuesit në Itali, Komisioni vlerëson se të ardhurat pasqyrohen për punën e tij si kamerier dhe jo të ardhura sipas parashikimit të kontratës me shoqërinë “***” s.r.l. (sipas të cilës, personi i lidhur do të përfitonte një kompensim prej 3% të të ardhurave neto të përfituara nga shoqëria, gjatë periudhës objekt i bashkëpunimit në pjesëmarrje, 28 korrik 1995 deri në datë 27 korrik 1996). Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk kishte mundësi për vërtetimin me dokumentacion të këtyre të ardhurave, Komisionit i rezulton se personi i lidhur/bashkëjetuesi nuk mundi të provonte pamundësinë, edhe pse iu kërkua nga ana e Komisionit në mënyrë të përsëritur.

Për më tepër, Komisioni, në përmbushje të parimit të objektivitetit:

- kreu përllogaritjet edhe në bazë të deklarimeve mbi të ardhurat e burimit të krijimit, nga të cilat rezultoi se në raport me shpenzimet e përafërta të përllogaritura në euro, sipas ISTAT-it, Itali¹⁴, të ardhurat janë të pamjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie.
- vlerësoi mbi mosparaqitjen e dokumenteve justifikuese¹⁵, për pamundësinë objektive për t'i disponuar ato në kuptim të nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 84/2016. Në këtë drejtim nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të provonte përmbushjen e elementeve të kësaj dispozite. Ai nuk informoi në asnjë rast Komisionin, se nga marrëdhënia me bankën “Monte Dei Paschi Di Siena”, me Institutin e Kontributeve Shoqërore të Punëdhënësit (INPS), apo me shoqërinë “***” s.r.l., është vënë në dijeni se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Përkundrazi, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shoqëria është aktive dhe Komisioni mund të investojë për të marrë informacion. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e saj ka përllogaritur në vitin 1992 shpenzime për bashkëjetuesin si student në atë kohë për tre muaj, ndërkohë që të ardhurat nga bursa kanë qenë të akorduara për katër muaj. Të ardhurat e përfituara nga bursa e akorduar nga Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunimin për Zhvillim, pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme italiane, për subjektin e lidhur/bashkëjetuesin i përkasin një periudhe 28-mujore, por sipas dokumentacionit të administruar, ato nuk janë të plota dhe për pasojë nuk provojnë

¹⁴ Referojuni rubrikës përkatëse në tabelën më poshtë.

¹⁵ Subjekti ka deklaruar se “...periudha që personi i lidhur ka punuar në Itali (prej 1992) i përket një kohe shumë të largët e për pasojë ka vështirësi në gjetjen e dokumentacionit...”.

nëse kanë kaluar për llogari të personit të lidhur. Dokumentet e administruara pasqyrojnë akordimet e bursave apo komunikimin në lidhje me rinovimin e saj.

Komisioni çmon se të ardhurat nga bursat janë akorduar për një qëllim të caktuar dhe për këtë shkak nuk mund të krijohen prej tyre sasi të konsiderueshme kursimesh për t'u përdorur për blerje pasurie. Edhe sa u përket të ardhurave të përfituara nga "puna në të zezë", i punësuar nuk mund të angazhohej në një marrëdhënie të paligjshme për të krijuar kursime të mëdha, pasi ato mund të mbulojnë vetëm nevojat ditore. Në këto kushte, Komisioni gjykon se të ardhurat e pretenduara nga bursa dhe puna në të zezë nuk janë burime të bindshme për justifikimin e kësaj pasurie.

2. Në lidhje me apartamentin 2 + 1 + verandë, me sipërfaqe totale 58.75 m², në pjesë takuese 50%, komuna ***, fituar me anë të kontratës së sipërmarrjes, datë 05.10.2010, për një vlerë totale 5 100 000 lekë (pesë milionë e njëqind mijë lekë). **Burim i deklaruar i krijimit:**Të ardhurat nga kursimet ndër vite¹⁶.

2.1. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave kërkoi dhe administroi nga institucionet:

- ✓ Shkresë nr. ***. prot., datë 04.12.2017, drejtuar ZVRRP-së Durrës, për depozitimin e praktikës, shoqëruar edhe me aktin e rivlerësimit.
- ZVRRP Durrës, me shkresën nr. *** prot., ka dërguar kartelën e pasurisë, sipas së cilës rezulton se Znj. Altina Xhoxhaj dhe Z. A.I kanë në pronësi pasurinë nr. ***, vol. ***, faqe ***, e llojit apartament, me sipërfaqe 58.75 m², ZK ***.
- ✓ Në praktikë është administruar kontrata e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol, datë 03.09.2013, për blerjen e pasurisë nr. ***, vol. ***, faqe ***, e ndodhur në ZK ***, me sipërfaqe 58.75 m², sipërfaqe ballkoni 21.41 m², sipërfaqe shkalle 6.71 m², sipërfaqe totale 86.87 m².
- ✓ Shkresë nr. *** prot., datë 05.12.2017 dhe nr. *** prot., datë 11.12.2017, drejtuar shoqërisë ndërtuese "****" sh.p.k., që të depozitojë librin (ditarin) e lëvizjes së parave, për vitet 2009 deri në vitin 2012.
- Me shkresën e datës 18.01.2018, shoqëria "****", sh.p.k. ka dërguar kontratën e sipërmarrjes të datës 05.10.2005 lidhur midis subjektit të rivlerësimit dhe subjektit të lidhur me të/bashkëjetuesit dhe kontratën e shitjes nr. *** rep., *** kol., datë 03.09.2013 dhe mandatarkëtimet.
- ✓ Shkresë nr. *** prot., datë 15.01.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
- Me shkresën nr. *** prot., datë 05.02.2018, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informon:

¹⁶ **Dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit për këtë pasuri:**

Kontratë e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol, datë 3.9.2013, ndërmjet shoqërisë "****" sh.p.k. dhe blerësve Z. A.I dhe Znj. Altina Xhoxhaj, për blerje apartamenti me sip. 58.75 m², me çmim 5.100.000 lekë, në ***.

Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 4.4.2013, për apartament me sip. 58.75 m², në emër të shoqërisë "****" sh.p.k. + kartela e pasurisë + praktika.

Kontratë sipërmarrjeje, datë 5.10.2010, për porosinë e apartamentit në ***, me vlerë 5.100.000 lekë.

Certifikatë pronësie me nr.***, datë 05.09.2013 për apartamentin me sip. 58.75 m², në ***, me pronar Z. A.I dhe Znj. Altina Xhoxhaj.

“Nga verifikimi i dokumentacionit në dosjen e tatimpaguesit në arkivin e institucionit tonë, si dhe referuar të dhënave të sistemit tatimor C@TS, rezultoi se nuk disponohen kontratat e sipërmarrjes së datës 05.10.2010 dhe kontrata noteriale e shitjes me nr. *** rep., ***kol., datë 03.09.2013. Gjithashtu, nuk disponohet informacion nga ana jonë lidhur me lëshimin e faturave tatimore përkatëse për këto transaksione, si dhe me mënyrën e kryerjes së pagesës”.

- ✓ Shkresë nr. *** prot., datë 10.04.2018, drejtuar ILDKPKI-së, për opinion ligjor.
- Me shkresën nr. *** prot, datë 16.04.2018, ILDKPKI-ja ka informuar mbi kërkimin e bërë¹⁷.

2.2 Komisioni, me vendimin nr. 2, datë 16.03.2018, të trupës gjyquese nr. 2, vendosi të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit dhe më datë 19.03.2018 njoftoi subjektin e rivlerësimit se mund të njihet me dokumentet e dosjes dhe se Komisioni ka arritur në përfundimin se provat e administruara në lidhje me këtë pasuri kanë nivelin e provueshmërisë, duke i dërguar subjektit të rivlerësimit rezultatet e hetimit kryesisht, duke njoftuar subjektin se i ka kaluar barra e provës për të provuar të kundërtën, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa më poshtë rezulton se:

Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme në vlerën 450 000 lekë (2 250 000-1 800 000), për krijimin e kësaj pasurie për sa më poshtë:

- i. Referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar 0 lek likuiditet;
- ii. Referuar deklaramëve periodike nga subjekti i rivlerësimit, në vitet 2006, 2007, 2008, 2009 ka pasur likuiditete në vlerën 1 800 000 lekë;
- iii. Sipas kontratës së sipërmarrjes, datë 05.10.2010, në rubrikën “mënyra e pagesës” është cituar shprehimisht se “janë parapaguar 4 500 000 lekë, sipas “mandatarkëtimeve përkatëse”;
- iv. Sipas deklaramit me e-mail, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka shlyer gjysmën e detyrimit për këtë pasuri, e barasvlershme me 2 250 000 lekë.

2.3 Subjekti i rivlerësimit, më datë 07.04.2018 dërgoi me anë të postës elektronike parashtrimet e saj¹⁸ ku, ndër të tjera, për këtë pasuri është shprehur se:

- Ka paguar sipas pjesës takuese, shumë prej 2 250 000 lekësh për pasurinë në fjalë dhe ka pasur të ardhura të mjaftueshme.
- Ekspertët llogarisin sikur subjekti i rivlerësimit ka filluar punë në vitin 2005 dhe gjendja e saj financiare në këtë vit ka qenë zero, fakt që e ka konstatuar dhe në analizën që është bërë për rastin e saj. Ka dhënë kontribut në institucionet e drejtësisë shqiptare, që në vitin 1994, pasi ka filluar punë në vitin 1994, si dhe ka pasur të ardhura edhe më parë, gjatë kohës që ka qenë studente, periudhë në të cilën ka përfituar bursë “Tempus” për periudhën 1992-1993.
- Në lidhje me deklaramin e gjendjes *cash*, pretendon se nuk ishte detyrim ligjor në zbatim

¹⁷ Detyrimi ligjor i subjekteve deklaram për deklaramin e vlerës së likuiditeteve, gjendja *cash* etj., para fillimit të detyrës, si dhe çdo vit, ndryshimet e ndodhura deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës, të interesave private është detyrim i përcaktuar shumë qartë që në fillim, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9049/2003 “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, botuar në Fletoren Zyrtare, nr. 31 maj 2003 dhe nuk mund të vihet në diskutim.

¹⁸ Referojuni parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit në dosje.

të legjislacionit të kohës.

- Duhet marrë në konsideratë marrëdhëniet e posaçme familjare, pra gjendjen e likuiditeteve të familjes.
- Nuk janë përfshirë pagat për periudhën janar-tetor 2010, si edhe të ardhurat nga shitja e makinës (gjysma e vlerës së saj) në maj të vitit 2010;
- Për vitin 2009, tek të ardhurat e realizuara nga personi i lidhur/bashkëjetuesi nuk janë pasqyruar të ardhurat e realizuara gjatë vitit si ekspert i ODIHR-it (rreth 8700 euro), të cilat janë të dokumentuara që me Deklaratën “Vetting”, me vërtetimin e datës 2 nëntor 2016, të lëshuar nga zyra e financës së ODIHR-it në Varshavë.

Subjekti i rivlerësimit, edhe në seancë dëgjimore u qëndroi parashtrimeve të depozituara pas kalimit të barrës së provës, si më lart cituam.

2.4 Arsytimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm:

Komisioni, duke pasur parasysh deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në Deklaratën e Pasurisë për Procesin e Rivlerësimit Kalimtar, “Vetting”, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të postës elektronike, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe avokatja e saj, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, arsyeton se:

- (i) Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme në vlerën 450 000 lekë (2 250 000 -1 800 000) për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2010 të deklaruar prej saj dhe të provuar me anë të kontratës, provuar kjo me:
 - a. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit me anë të postës elektronike (*e-mail*-in e datës 16.02.2018) ku është shprehur se: “...Gjithsesi në të vetmen pronë që subjekti kishte arritur të investonte me të ardhurat e saj, Komisioni mund të llogarisë në dy pagesat e bëra, 50 % shpenzim në ngarkim të saj.”.
 - b. Kontratën e sipërmarrjes, datë 5.10.2010, në rubrikën “Mënyra e pagesës” ku është cituar shprehimisht se “Janë parapaguar 4.500.000 lekë sipas mandatarkëtimeve përkatëse”.
 - c. Analizën financiare të kryer nga ana e Komisionit, referuar deklaratimeve periodike të subjektit në vitet 2006, 2007, 2008, 2009 se ka likuiditete në vlerën 1 800 000 lekë, ilustruar me anë të tabelës më poshtë:

Vitet	Shtesa në likuiditete
2 010	1 200 000
2 011	1 200 000
2 012	1 400 000
2 013	1 400 000
2 014	1 100 000
2 015	-
2 016	-
Totali	6 300 000

Komisioni, në përlllogaritje ka përfshirë të ardhurat nga paga e gjithë vitit 2010, të ardhurat nga shitja e makinës në vitin 2010, vlerën 8700 euro të pretenduar, e cila sipas dokumentit përkatës¹⁹ ka rezultuar të jetë përfituar pjesërisht në vitin 2009, në shumën 2 100 euro dhe pjesërisht në vitin 2010, në shumën 5 319 euro.

Megjithëse subjekti pretendon se të ardhurat kanë datuar që prej nisjes së punës së saj në vitin 1994, Komisioni konstaton se ato janë pasqyruar tërësisht në deklaratën e plotësuar për herë të parë në vitin 2003. Komisioni, pikërisht duke u nisur nga marrëdhëniet e posaçme familjare, për të cilat subjekti pretendon se nuk janë konsideruar, ka konstatuar në deklarinimin e bërë nga babai i subjektit në vitin 2004 se të gjitha kursimet familjare, përfshirë edhe 2 000 000 lekët e deklaruara në vitin 2003, edhe vlera 35 000 dollarë, apo edhe huaja e marrë në shumën 1000 000 lekë, janë shpenzuar për përfundimin e shtëpisë së ndodhur në ***, në pronësi të nënës së subjektit të rivlerësimit. Nën këtë arsyeim provohet se subjekti i rivlerësimit ka ardhur në vitin 2005 me gjendje likuiditeti 0 (zero).

Nga deklarinimet e subjektit është pretenduar se, në zbatim të legjislacionit të kohës, nuk ka pasur detyrim ligjor që të deklaronte shtesa për gjendjen *cash* ose kursimet për vitin përkatës të deklarinimit. Një detyrim i tillë, shprehet subjekti, ka hyrë në fuqi me ndryshimet që iu bënë ligjit nr. 9049/2003 me ligjin nr. 45/2014 (neni 2), ku zyrtari detyrohej të deklaronte dhe vlerën e likuiditeteve ose gjendje *cash* në banesë, ndërsa ILDKPKI-ja me shkresën Nr. *** prot., datë 16.04.2018²⁰, ndër të tjera ka qartësuar se detyrimi ligjor i subjekteve deklarues për deklarinimin e vlerës së likuiditeteve, gjendjes në *cash* etj., para fillimit të detyrës, si dhe çdo vit, është detyrim i përcaktuar shumë qartë që në fillim, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 31 maj 2003, dhe nuk mund të vihet në diskutim.

3. Në lidhje me pasurinë, truall me sipërfaqe 221.9 m² (kalim i së drejtës së pronësisë mbi truallin e njësisë së ndërtuar), në pjesë takuese 50%, me shumën 411 249 lekë (katërqind e njëmbëdhjetë mijë e dyqind e dyzet e nëntë), me adresë komuna ***, 23 shtator 2014, fituar me anë të kontratës nr. *** rep., ***kol., datë 26.09.2013.

3.1 Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave kërkoi dhe administroi nga institucionet:

- ✓ Shkresë nr. *** prot., datë 04.12.2017, drejtuar ZVRPP-së ***, për depozitimin e praktikës, shoqëruar edhe me aktin e rivlerësimit.
- ZVRRP Durrës, me shkresën nr. *** prot. ka dërguar kartelën e pasurisë, sipas të cilës rezulton se: Znj. Altina Xhoxhaj dhe Z. A.I kanë në pronësi pasurinë nr. ***, vol. ***, faqe ***, e llojit truall, me sipërfaqe 221.9 m², ZK ***, me adresë ***.
- ✓ Në këtë praktikë është administruar kontrata e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore nr. *** rep., ***kol., datë 26.09.2013.

¹⁹ Shkresë e datë 2 nëntor 2016 e OSCE-së.

²⁰ Për më shumë referojuni shkresës së administruar në dosje.

- ✓ Shkresë nr. *** prot., datë 13.02.2018, drejtuar Drejtorisë së ALUIZNI-t “Tirana 3”, nëpërmjet të cilës kërkohet informacion se ku bazohet (përfshirë legjislacionin, metodologjinë, standarde, përllogaritje me formulë etj.) përcaktimi i sipërfaqes së truallit që ka blerë subjekti i rivlerësimit (221 m²), pavarësisht kërkesës së bërë për 50 m².
- Me shkresën nr. *** prot., datë 05.03.2018, ALUIZNI ka informuar se: “Sipas formulës, sipërfaqja apartamenti x koeficienti i shfrytëzimit, pjesa takuese e truallit do të ishte 122.89 m².”.
- ✓ Kontratë e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore nr. *** rep., nr. *** kol, datë 26.9.2013 ndërmjet ALUIZNI-t, si palë shitëse dhe Z. A.I dhe Znj. Altina Xhoxhaj palë blerëse për kalimin e sipërfaqes takuese prej 221.9 m², me vlerë 411.249 lekë + praktika e ALUIZNI-t.

3.2 Komisioni, me vendimin nr. 2, datë 16.03.2018, të trupës gjyquese nr. 2, vendosi të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit dhe, më datë 19.03.2018, njoftoi subjektin e rivlerësimit se mund të njihet me dokumentet e dosjes dhe se Komisioni ka arritur në përfundimin se provat e administruara në lidhje me këtë pasuri kanë nivelin e provueshmërisë, duke i dërguar subjektit të rivlerësimit rezultatet e hetimit kryesisht, duke njoftuar subjektin se i ka kaluar barra e provës për të provuar të kundërtën, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa më poshtë rezulton:

- ✓ Në kontratën e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore keni përfituar sipërfaqe mbi atë takuese, në raport me sipërfaqen e ndërtimit, për sa më poshtë:
 - Në dosjet respektive të institucioneve përgjegjëse, ALUIZNI dhe ZVRPP, nuk disponohet një akt mbi të cilën të pasqyrohet mënyra e përllogaritjeve sipas ligjit nr. 10186, datë 05.11.2009 dhe VKM-së nr. 187, datë 06.03.2013;
 - Drejtoria e ALUIZNI-t, me shkresën nr. ***, datë 05.03.2018, informon se pjesa takuese e truallit duhet të ishte 122.89 metra katrorë.
 - Nuk rezulton që banorët e tjerë të kenë hequr dorë nga sasia e metrave katrorë sipas ligjit nr. 10186, datë 5.11.2009, nga sipërfaqja e tyre takuese;
 - Nuk rezulton ndonjë titull privilegjues, në bazë të të cilit të përfitonit nga privatizimi edhe i pjesëve /sipërfaqeve ndërtimore, që sipas ligjit u takonin pronarëve të tjerë;
 - Një përjashtim i tillë nuk rezulton as në marrëdhëniet e ndërtuesit me porositësit e sipërfaqeve ndërtimore në këtë parcelë ndërtimore;

3.3 Subjekti i rivlerësimit, më datë 07.04.2018 dërgoi me anë të postës elektronike parashtrimet e saj²¹ ku, ndër të tjera, për këtë pasuri është shprehur se:

- Prej tyre si pronarë të banesës ishte kërkuar vetëm njolla nën apartament, pa përfshirë ambientet e përbashkëta, pra vetëm për 50 m².
- Por, edhe nëse Komisioni i referohej shkresës së datës 05.03.2018 të ALUIZNI-t, me një llogaritje të thjeshtë, pra nëse bëhej mbledhja e sipërfaqes së truallit prej 122.89 m² me sipërfaqen që zë njolla e apartamentit (ku përfshihej dhe veranda) prej 86.87 m² (sipas llogaritjeve të vitit 2018), në total sipërfaqja e truallit do të rezultonte 209.76 m² dhe diferenca do të ishte 12.14 m².

²¹ Referojuni parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit në dosje.

- Praktika e vitit 2013 provonte plotësisht se pagesa ishte bërë për oborrin dhe sipërfaqen takuese nën ndërtesë.
- Nuk kishte pasur asnjë trajtim preferencial, as nga ana e shoqërisë “***” dhe as nga ALUIZNI në këto llogaritje, të cilat ishin kryer tërësisht nga ALUIZNI dhe jo me kërkesë të saj apo personit të lidhur/bashkëjetuesit.

Subjekti i rivlerësimit edhe në seancë dëgjimore u qëndroi parashtrimeve të depozituara pas kalimit të barrës së provës.

3.4 Arsytimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm:

Komisioni, duke pasur parasysh deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në Deklaratën e Pasurisë për Procesin e Rivlerësimit Kalimtar “Vetting”, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të postës elektronike, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe avokatja e saj për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, arsyeton se:

- (i) Për këtë pasuri subjekti i rivlerësimit, Znj. Altina Xhoxhaj, ka përfituar sipërfaqe më tepër se sa i takonte në bazë të ligjit nr. 10186, datë 5.11.2009, dhe VKM-së nr. 187, datë 06.03.2013, si dhe nuk ka paguar truallin e përfituar më tepër me vlerën e tregut, provuar kjo me:
 - a. Shkresën nr. *** prot., ku ZVRRP *** ka konfirmuar truall me sipërfaqe 221.9 m², me adresë ***, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, si dhe ka dërguar kopje të aktit të rivlerësimit të kësaj pasurie me shkresën nr. *** prot., datë 08.01.2018, edhe pse në formularin nr. *** prot., datë 08.10.2010, nga të dy subjektet (subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/ bashkëjetuesi) është kërkuar blerja e sipërfaqes së truallit, vetëm për 50 m².
 - b. Shkresën nr. ***, datë 05.03.2018, të Drejtorisë së ALUIZNI-t, ku konfirmohet se pjesa takuese e truallit duhet të ishte 122.89 metra katrorë.
 - c. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nëse Komisioni i referohej shkresës së datës 05.03.2018 të ALUIZNI-t, me një llogaritje të thjeshtë, pra nëse bëhej mbledhja e sipërfaqes së truallit prej 122.89 m² me sipërfaqen që zinte njolla e apartamentit (ku përfshihej dhe veranda) prej 86.87 m² (sipas llogaritjeve të vitit 2018) në total sipërfaqja e truallit rezulton 209.76 m² dhe diferenca është prej 12.14 m², Komisioni vlerëson se ALUIZNI në përgjigjen e dhënë ka përfshirë në sipërfaqen e truallit (që subjektit të rivlerësimit i takonte realisht për të blerë), edhe sipërfaqen që zë njolla e apartamentit. Lidhur me këtë pasuri, nuk rezultoi që subjekti të kishte ndërmarrë ndonjë veprim për të ditur përse iu dha sipërfaqe e tepërt truallit kur me kërkesë kishte kërkuar një sipërfaqe të caktuar. Komisioni vlerëson se subjekti duhet të kishte përfituar sipërfaqe aq sa i takonte, provuar kjo me shkresën e ALUIZNI-t nr.1229/1, datë 05.03.2018.

4. Likuiditete të subjektit të rivlerësimit në shumën prej 6 300 000 (gjashtë milionë e tridhjetë mijë) lekë, dhe të personit të lidhur/bashkëjetuesit në shumën prej 61 484 USD dhe 15 000 euro.

Burimi i deklaruar i krijimit të likuiditeteve të subjektit të rivlerësimit: Kursimet nga pagat, trajnimet, mësimdhënia ndër vite.

Burimi i deklaruar i krijimit likuiditeteve të personit të lidhur/bashkëjetuesit: Kursime nga të ardhurat ndër vite nga pagat, honorarët/dietat në misione vëzhgimi me OSCE/ODIHR IRS dhe qiraja e apartamentit.

4.1 Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave kërkoi dhe administroi:

- ✓ Deklarime të subjektit në Deklaratën “Vetting”;
 - ✓ Deklarime të bëra ndër vite në deklaratat vjetore;
 - ✓ Dokumentacionin e depozituar nga vetë subjekti dhe të konfirmuar nga sistemi bankar;
 - ✓ Korrespondencën zyrtare mbajtur me institucionet punëdhënëse të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për konfirmimin e rimbursimit të shpenzimeve mbi udhëtimet e tyre për nevoja pune;
 - ✓ Verifikimin e hyrje-daljeve nga sistemi TIMS²²;
 - ✓ Shkresën nr. *** prot., datë 04.12.2017, drejtuar 27 bankave dhe institucioneve të tjera financiare.
- “ProCredit Bank”, me shkresë nr. prot. ***, datë 21.12.2017, informon se: Znj. Altina Xhoxhaj dhe Z. A.I kanë pasur llogari rrjedhëse: përkatësisht Znj. Altina Xhoxhaj, në monedhën lekë, mbyllur më datë 21.07.2016 dhe Z. A.I llogari rrjedhëse në monedhën euro, mbyllur më datë 29.05.2008 dhe llogari rrjedhëse në monedhën lekë, mbyllur më datë 01.11.2008.
 - Banka “NBG Albania” sh.a., me shkresë nr. ***, datë 05.12.2017, informon se: Znj. Altina Xhoxhaj ka pasur llogari kredie në monedhën dollarë amerikanë (USD), e hapur më datë 10.03.2003, në shumën 40 000 USD, me afat maturimi 15-vjeçar, me shlyerje të parakohshme më datë 01.04.2008; llogari rrjedhëse, në monedhën USD, e hapur më datë 10.03.2003 dhe e mbyllur më datë 01.02.2010.
 - Banka “Raiffeisen”, me shkresë nr. *** prot., datë 11.12.2017, informon se: Znj. Altina Xhoxhaj ka pasur llogari page në lekë me nr. 2400419446, me gjendje 961,389.63 lekë; llogari në valutë për tërheqje me *Master Card* me nr. ***, me gjendje zero euro; llogari rrjedhëse në valutë me nr. ***, me gjendje 988.65 euro. Z.A.I ka pasur llogari page në lekë me nr. ***, me gjendje 12.83 lekë; llogari në valutë me nr. ***, me gjendje zero CAD; llogari në valutë me nr. ***, me gjendje 133.15 euro; llogari në valutë me nr. ***, me gjendje 2,868.22 USD.
 - ✓ Gjendjet e likuiditeteve (në llogaritë bankare dhe *cash* në shtëpi) të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur/bashkëjetuesit, që rezultuan sipas deklarimit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion në dosje, në fund të vitit 2016, janë nga institucionet bankare “Wells Fargo Bank” SHBA; “US Bank” SHBA; Kartë krediti; “Raiffeisen Bank Albania”, si dhe gjendje *cash* në banesë.

4.2 Komisioni, pasi arriti në përfundimin se provat e administruara në lidhje me këtë pasuri kanë nivelin e provueshmërisë, i dërgoi subjektit të rivlerësimit rezultatet e hetimit kryesisht, duke njoftuar subjektin se i ka kaluar barra e provës për të provuar të kundërtën,

²² Referojuni dokumenteve të printuara pas aksesit të Komisionit në sistemin TIMS, për subjektin e rivlerësimit, personin e lidhur me të dhe fëmijët.

në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si më poshtë rezultoi se:

- ✓ Nga analizimi i të dhënave për vitin 2007, 2009 dhe 2015, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit të ligjshëm financiar, për të justifikuar shumën prej 1 972 969 (një milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e dymijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë.

4.3 Bazuar në sa më lart, subjekti rivlerësimit, më datë 07.04.2018 dërgoi me anë të postës elektronike parashtrimet e saj²³ ku, ndër të tjera, për këtë pasuri pretendon se:

Në total, për vitin 2007 shpenzime udhëtimi janë më shumë se çfarë i rezulton për vete dhe personin e lidhur/bashkëjetuesin, duke llogaritur Lekë 41.109 + Lekë 78.904 + 120.910 + Lekë 386.912 = 627.835.

Të gjitha udhëtimet për vitin 2009 kanë qenë në funksion të detyrës së saj si anëtare e KLD-së dhe rrjedhimisht shpenzimet janë përballuar nga KLD-ja ose të mbështetura nga EURALIUS/Këshilli i Europës, si dhe nuk ka bërë asnjë rrugë private duke pretenduar se ngarkimi i shpenzimeve të tilla është i pasaktë dhe se në përlllogaritjet e Komisionit ka një mbivlerësim në vlerën **277 769 lekë**.

Te të ardhurat e realizuara të personit të lidhur/bashkëjetuesit nuk janë pasqyruar të ardhurat e realizuara gjate vitit si ekspert i ODHIR-it (rreth 8700 euro), të cilat janë të dokumentuara që në Deklaratën “Vetting”, me vërtetimin datë 2 nëntor 2016, lëshuar nga zyra e financës së ODHIR-it në Varshavë. Nëse do të përfshihej dhe kjo e ardhur, analiza financiare nuk do të ketë diferencë të pambuluar, siç pretendohet.

Ndërsa, për sa i përket konstatimit të mungesës së burimit financiar, për të justifikuar shumën prej 557 753 lekësh, për vitin 2015, subjekti i rivlerësimit pretendon se i janë ngarkuar pa të drejtë një sasi e madhe udhëtimesh që nuk gjejnë pasqyrim në sistemin TIMS.

Subjekti i rivlerësimit edhe në seancë dëgjimore u qëndroi parashtrimeve të depozituara pas kalimit të barrës së provës.

4.4 Arsyetimi i analizës së likuiditeteve për vitet 2007, 2009 dhe 2015

Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit të ligjshëm financiar, për të justifikuar shumën prej 1 972 969 (një milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e dymijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekësh, provuar kjo me:

- i.** Diferencën e pajustificuar me burime financiare të ligjshme për vitet 2007, 2009 dhe 2015, sipas analizës financiare më poshtë:

²³ Referojuni parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit në dosje.

Përshkrimi	2007	2009	2015
Gjendja e likuiditetit në fillim të periudhës për subjektin e rivlerësimit ²⁴ Lekë	415 251	992 902	13 411 525
Gjendja e likuiditetit në fillim të periudhës për personin e lidhur/bashkëjetuesin Lekë	2 215 550	3 168 211	1 979 725
Të ardhura të dokumentuara, të subjektit rivlerësimit ²⁵ Lekë	952 185	1 208 664	1 140 028
Të ardhura të dokumentuara, të personit të lidhur/bashkëjetuesi Lekë	1 241 000	1 467 300	450 460
Shpenzime jetese, sipas ILDKPKI-së ²⁶ Lekë	771 429	277 769	771 429
Shpenzime udhëtimesh bazuar në sistemin TIMS ²⁷ Lekë	678 134	771 429	864 087
Shpenzime për shlyerje kredie ²⁸ Lekë	504 309	-	-
Gjendja e likuiditetit (datë 31 dhjetor) Lekë	3 320 212	6 860 054	15 903 976
Diferenca e pajustificuar me burim financiar të ligjshëm Lekë	-450,097	-965,119	- 557,753

*Shpenzimet e udhëtimit sipas sistemit TIMS²⁹ për subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur/bashkëjetuesin janë përlllogaritur në bazë të një kostoje mesatare (kostoja mesatare e biletës referuar mesatares së çmimit më të lartë dhe më të ulët të biletës për periudhat përkatëse si dhe një kostoje mesatare prej 50 eurosh shpenzime ditore) dhe konvertimi i tyre në lekë është realizuar referuar kursit mesatar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të vitit përkatës.

- ✓ Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit në lidhje me mungesën e burimit të ligjshëm financiar të vitit 2007, në shumën prej – 450.097 lekësh, se udhëtimi i personit të lidhur/bashkëjetuesit ka qenë drejt SHBA-ve dhe se në këtë destinacion ka udhëtuar më parë edhe vetë subjekti i rivlerësimit për lindjen e djalit, për të cilën depozitoi deklaratën noteriale të datës 31 mars 2018, për të provuar shpenzimet e qëndrimit, si dhe dokumentin e datës 11 korrik 2007 për të provuar se ishte përfshirë në programin e ndihmës ekonomike për lindjen e fëmijës, Komisioni gjykoj se kjo deklaratë nuk konsiderohet si provë për shkak se është hartuar gjatë hetimit administrativ.

²⁴ Te gjendja e likuiditetit në fillim të periudhës janë të përfshira likuiditetet *cash* dhe kursimet nga pagat në banesë të deklaruara prej subjektit të rivlerësimit dhe bashkëjetuesit, si dhe gjendja e llogarisë së bankës në fillim të periudhës.

²⁵ Të ardhurat nga paga për subjektin dhe bashkëjetuesin janë marrë nga vërtetimet e punësimit që subjekti ka depozituar në dosje.

²⁶ Për shpenzimet e jetesës janë marrë në konsideratë shpenzimet e jetesës sipas ILDKPKI-së, me një vlerë prej 9 000 000 lekësh nga viti 2003-2016, e shpërndarë në vite, duke u bazuar te përbërja familjare.

²⁷ Për shpenzimet e udhëtimeve u jemi referuar të dhënave të gjeneruara nga sistemi TIMS dhe bazë për llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimeve Komisioni ka marrë të dhënat nga TIMS, me çmim mesatar bilete sipas linjave ajrore, duke filluar nga 180 euro për udhëtim për linjat *low cost* deri në 300 euro për udhëtim për linjat më të gjata. Në rastet kur informacioni u referohet destinacioneve të largëta, shpenzimet e udhëtimit janë llogaritur sipas çmimeve të publikuara në internet. Shpenzimet janë llogaritur 50 euro/ditë (shpenzim qëndrimi dhe ushqimi).

²⁸ Shpenzimet për shlyerje kredie të deklaruara nga subjekti dhe të vërtetuara nga dokumentacioni i marrë nga banka i referohen kredisë prej 40 000 dollarësh, që subjekti ka marrë në vitin 2003 për të cilën shlyen 50% të detyrimit, kurse 50% e shlyen babi i subjektit.

²⁹ Referojuni për më tepër metodikës së pasqyruar në përmbajtje të këtij vendimi.

- ✓ Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për shpenzime të pasakta që i janë ngarkuar, në shumën 41.109 lekë, nuk gjenden urdhra të brendshëm në KLD, pasi udhëtimi nuk financohej me fonde të buxhetit të shtetit dhe për këtë ka depozituar shkresën e KLD-së nr. *** prot., datë 03.04.2018, Komisioni gjykoi se, për sa kohë nuk provohet shkresërisht rimbursimi i shpenzimeve të udhëtimeve, ato nuk merren në konsideratë për efekt llogaritjesh.
- ✓ Ndërsa në lidhje me pretendimin se shumat prej 78 904 lekësh dhe 168 883 lekësh nuk i janë llogaritur si shpenzim, Komisionit i rezulton se këto shpenzime janë përlllogaritur nga ana e këtij të fundit.
- ✓ Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit në lidhje me mungesën e burimit të ligjshëm financiar të vitit 2009, në shumën prej – 965,119 lekësh, se ato mbulohen nga punëdhënësi, në atë kohë KLD, por pa paraqitur asnjë dokumentacion shkresor provues, Komisioni nuk i merr në konsideratë për efekt llogaritjes, pasi nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk u paraqit asnjë provë shkresore, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Kushtetutës, që përcakton se: *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore...”*.
- ✓ Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, për mospasqyrimin në përlllogaritje të të ardhurave të personit të lidhur, të realizuara gjatë këtij viti si ekspert i ODHIR-it (rreth 8 700 euro), Komisioni e ka përlllogaritur këtë të ardhur sipas rimbursimit të saj, pjesërisht në vitin 2009 dhe pjesërisht në vitin 2010.
Komisioni, megjithëse i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës në lidhje me likuiditetet, ajo nuk provoi të kundërtën dhe për pasojë përlllogaritjet nuk ndryshuan lidhur me shpenzimet e kryera për udhëtimet.
- ✓ Për sa u përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në lidhje me mungesën e burimit të ligjshëm financiar të vitit 2015, në shumën prej – 557 753 lekësh se:
 - Udhëtimi i saj i datës 19 maj ka qenë për llogari të Gjykatës Kushtetuese dhe si rrjedhojë i janë ngarkuar shpenzime të tepërta, në vlerën 75.708 lekë. Komisioni vlerësoi dokumentin e depozituar nga subjekti, nr. *** prot., të datës 30.03.2018, të Gjykatës Kushtetuese, dhe pasi e mori në konsideratë, bëri rillogaritjet financiare.
 - Udhëtimi në këtë vit kalendarik i personit të lidhur/bashkëjetuesit drejt SHBA-ve, me detyrë funksionale shtetërore, së bashku me familjen, është rimbursuar nga shteti shqiptar; nuk ka asnjë shpenzim për biletë, për shkak se personi i lidhur ka përdorur *“miles and more”* për të blerë biletën e udhëtimit, subjekti nuk paraqiti prova shkresore dhe për këtë arsye Komisioni nuk i merr në konsideratë në përlllogaritjet financiare këto shpenzime.
 - Mungesa e shpenzimeve në vlerën 68 825 lekë për strehim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë qenë të mbuluara nga zyra e Misionit të Shqipërisë në OKB, qeveria shqiptare.
 - Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se sipas informacionit për shpenzimet e jetesës të marra nga ILDKPKI-ja për vitet 2003-2016 është në total 9 000 000 lekë nëse kjo përpjesëtohet në mënyrë të drejtë është 9 000 000/14 vjet = 642 ,852 lekë mesatarisht për vit. Gjithashtu, ka deklaruar subjekti, nuk merren parasysh të ardhurat e subjektit, që ka qenë në marrëdhënie pune që prej vitit 1994. Nuk merret parasysh dhe fakti që

familja nuk ka pasur makinë që prej vitit 2010 dhe nuk ka pasur asnjë shpenzim për makinë dhe telefon.

- Komisioni në lidhje me përlllogaritjen e shpenzimeve për konsum familjar mesatar vjetor nuk ka vlerësuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit, i cili kërkon shpërndarje të shpenzimeve në përpjesëtim të drejtë për vitet 2003-2016 të totalit 9 000 000 lekë, mesatarisht, për 14 vjet = 642 852 lekë, për shkak se në këtë përlllogaritje merret në konsideratë përbërja familjare nga vit në vit.
- Në këto kushte, Komisioni nuk mund të kryejë rillogaritje në përpjestim të drejtë të zërit të shpenzimeve për jetesën, por ka llogaritur shpenzime familjare, për vitin 2004, për tre anëtarë të familjes, bashkëjetuesit dhe vajzën e tyre, për vitin 2007 e në vijim për katër anëtarë të familjes, bashkëjetuesit dhe dy fëmijët e tyre.

Komisioni, pasi analizoi deklaratat e subjektit të rivlerësimit, vlerësoi dokumentacionin provues, për këtë vit kalendarik (2015) vlerësoi disa ndryshime në përlllogaritjet e bëra. Konkretisht, analiza financiare nuk përlllogariti në këtë vit shpenzimet e udhëtimeve në shumën 192 710 lekë, për vitin 2016 shumën 632 147 lekë, për shkak të udhëtimit në SHBA për marrjen e detyrës nga personi i lidhur/bashkëjetuesi, si dhe udhëtimin e datës 19-24 maj 2015 për qëllime pune, formalizuar me shkresën nr. *** prot., të datës 05.04.2018, nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, si dhe me shkresën nr. ***, të datës 30.03.2018, nga Gjykata Kushtetuese.

Komisioni, gjithashtu, në zërin “shpenzime” ka përfshirë edhe ato të shkollimit, bazuar në vërtetimet e depozitimeve cash në “Intesa Sanpaolo Bank” të datës 11 shtator 2012, 10 prill 2013, 31 dhjetor 2013, 10 prill 2014, 16 prill 2014, 4 shtator 2014 dhe 23 dhjetor 2014, të sjella nga subjekti i rivlerësimit për arsimimin e fëmijëve në sistemin arsimor privat, për vitin 2013 dhe 2015, pasi për vitin 2014 subjekti i rivlerësimit për këtë zë shpenzimi rezultonte të kishte deklaruar në deklaratën e pasurisë për vitin 2014.

Në përfundim, Komisioni ka arritur në konkluzion se përlllogaritja financiare në këtë vit kalendarik ka ndryshuar nga shpjegimet e dhëna dhe dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës, në shumën 100 631 lekë.

ii. Shpenzimet për udhëtime të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur/bashkëjetuesit sipas sistemit TIMS

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen shpenzimet e zbritshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur/bashkëjetuesit:

Për vitet	Shpenzime udhëtimi, subjekti i rivlerësimit Lekë	Shpenzime udhëtimi, personi i lidhur/bashkëjetuesi Lekë	Shpenzime udhëtimi në total Lekë
2016	317 885	91 307	409 192
2015	742 955	121 132	864 087
2014			560 440 ³⁰
2013	119 179	24 537	143 715

³⁰ Shpenzimet për udhëtime të deklaruara nga subjekti që përputhen me shpenzimet e gjeneruara nga sistemi TIMS në vlerën prej 4 000 eurosh.

2012	136 227	-	136 227
2011	200 535	69 150	269 685
2010	38 173	270 680	308 852
2009	277 769	-	277 769
2008	197 092		197 092
2007	105 796	572 337	678 134
2006	80 407	-	80 407
2005	67 397	-	67 397

Për të verifikuar burimin e krijimit të likuiditeteve të deklaruara nga subjekti, është kryer analiza financiare³¹ duke marrë për bazë:

- Deklarimet e subjektit në Deklaratën “Vetting”;
- Deklaratat ndër vite;
- Dokumentacionin e depozituar nga vetë subjekti dhe të konfirmuar nga sistemi bankar;
- Korrespondencën zyrtare mbajtur me institucionet punëdhënëse të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur/bashkëjetuesit për konfirmimin e rimbursimit të shpenzimeve mbi udhëtimet e tyre për nevoja pune;
- Verifikimin e hyrje-daljeve nga sistemi TIMS³².

- ❖ **Në lidhje me deklarin e gjendjes *cash*** në banesë në Tiranë të personit të lidhur/bashkëjetuesit , në shumën prej 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) eurosh, Komisioni çmon se ky veprim bie në kundërshtim me paragrafin e dytë të nenit 4/1 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, që specifikon se: *“Për subjektet që deklarojnë sipas nenit 5/1 të këtij ligji, depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve CASH mbi vlerën e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së interesave private në ILDKPKI”*.

III. ZBULIMI I ÇËSHTJEVE TË TJERA GJATË HETIMIT

Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë për vitin 2003 ka deklaruar:

5. Kredi në shumën 40 000 dollarë për blerjen e apartamentit (2+1), me sipërfaqe 120 m², në adresën blv. “***”, shoqëria “***”, kati i ***, në shumën 54 mijë dollarë, *me burim krijimi, përveç kredisë, edhe të ardhura familjare.*
 - i. Nisur nga fakti dhe rrethanat e shpenzimeve të kryera për efekt të një kredie të marrë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2003, shpenzime të cilat kanë impaktuar likuiditetet e pasqyruara në analizën financiare, u hetua mbi këtë kredimarrje.

5.1 Për vërtetimin e faktit, Komisioni administroi:

³¹ E pasqyruar përkatësisht në tabelën përmbledhëse për vitet 2007, 2009, 2015.

³² Referojuni dokumenteve të printuara pas aksesit të Komisionit në sistemin TIMS, për subjektin e rivlerësimit, personin e lidhur me të dhe fëmijët.

- ✓ Shkresë nr. ***prot., datë 04.12.2017, drejtuar Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë, si dhe institucioneve të tjera financiare në vend, për subjektin e rivlerësimit, Znj. Altina Xhoxhaj, personin e lidhur Z. A.I, si dhe për babain e subjektit të rivlerësimit, për shkak të deklarimeve të disa pasurive të luajtshme e të paluajtshme në mënyrë të përbashkët.
- “NBG”, me shkresën e saj nr. ***, datë 05.12.2017, ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit ka një llogari kredie në monedhën USD, hapur më datë 10.03.2003, pasi ka marrë kredi hipotekore në shumën 40 000 USD me afat maturimi 15-vjeçar, kredi e cila është shlyer para kohe nga babai i subjektit më 01.04.2008, si dhe një llogari rrjedhëse në monedhën USD, hapur më datë 10.03.2003 dhe mbyllur me datë 01.02.2010.
- ✓ Shkresë nr. *** prot., datë 15.01.2018, drejtuar bankës “NBG Albania” sh.a., në përputhje me nenin 56 të ligjit nr. 9662/2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë” lidhur me kredimarrjen e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e vitit 2003, në shumën 40 000 dollarë.
- “NBG”, me shkresën e saj ***, datë 16.01.2018, ka përcjellë praktikën në emër të kredimarrësit, subjektit të rivlerësimit, kontratë personale kredie me interes të ndryshueshëm 40 000 dollarë (vënie në hipotekë e pasurisë së paluajtshme), datë 26.02.2003.

Duke qenë se në praktikën e dërguar nga banka “NBG”, nuk u gjend asnjë dokument ligjor për blerje, porosi etj., apo edhe ndonjë marrëveshje si burim për dhënien e kredisë, bazuar në nenin 49/1/b të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i është kërkuar të japë deklarime dhe prova lidhur me këtë përfitim pasuror.

Në përgjigjen e saj, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se blerja provohet me kontratën e shitjes së apartamentit nr. *** rep., nr. *** kol., në emër të motrës, Znj. A.Xh, e cila në veprimet e kryera është përfaqësuar nga babai, Z. S.Xh, nëpërmjet prokurës nr. *** prot., datë 18.7.2007.

5.2 Komisioni, me vendimin nr. 2, datë 16.03.2018, të trupës gjyquese nr. 2, vendosi të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit dhe më datë 19.03.2018 njoftoi subjektin e rivlerësimit se mund të njihet me dokumentet e dosjes dhe se Komisioni ka arritur në përfundimin se provat e administruara në lidhje me këtë pasuri kanë nivelin e provueshmërisë, duke i dërguar subjektit të rivlerësimit rezultatet e hetimit kryesisht, duke njoftuar subjektin se i ka kaluar barra e provës për të provuar të kundërtën, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa më poshtë rezulton:

- ✓ Veprimet e kryera nga ana subjektit të rivlerësimit në cilësinë e kredimarrëses nuk përputhen me kohën kur është realizuar blerja e kësaj pasurie, për sa më poshtë:
 - a. Shlyerja e apartamentit të deklaruar si i blerë nëpërmjet kësaj kredie është bërë përpara disbursimit të kredisë.
 - b. Kontrata e paraqitur si provë për marrjen e kësaj kredie mban datën 01.10.2007, me palë shitëse shoqëria “***” sh.p.k., dhe palë blerëse Znj. A.S.Xh (motra e subjektit të rivlerësimit) e përfaqësuar me prokurë të posaçme nga babai i subjektit të rivlerësimit.

- c. Në kontratë citohet se shlyerja e apartamentit është bërë në dy këste, respektivisht më datë 24 janar 2003 në shumën 30 000 USD dhe më datë 28.02.2003 në shumën 24 450 USD.

5.3 Bazuar sa më lart, subjekti i rivlerësimit, më datë 07.04.2018, dërgoi me anë të postës elektronike parashtrimet e saj³³ ku, ndër të tjera, për këtë pasuri pretendon se:

Ky veprim juridik nuk ishte kryer prej saj, dhe se në atë kontratë kishte pasaktësi. Pretendon mbi një gabim të pastër material për sa u takon kësteve të paguara dhe vlerës së tyre. Kjo kontratë, edhe pse ishte hartuar në tetor të vitit 2007, u referohej dy shlyerjeve të fillimvitit 2003, por pa pasur bashkëlidhur mandate arkëtimi ose ndonjë provë tjetër që të provonte atë çfarë deklarohej aty në lidhje me këto pagesa të kryera jashtë zyrës së noterit.

Bashkëlidhur deklarimeve, subjekti depozitoi:

- Kontratën nr. *** rep., *** kol., datë 01.10. 2007;
- Deklaratën noteriale datë *** rep., *** kol., datë 05.04.2018, lidhur midis shoqërisë “***” sh.p.k. dhe Z. S.Xh;
- Transfertë e “Dardania Bank”, 10 mars 2003;
- Mandat arkëtimi, datë 31.01.2003;
- Mandat arkëtimi, datë 9.07.2007.

Subjekti i rivlerësimit edhe në seancë dëgjimore u qëndroi parashtrimeve të depozituara pas kalimit të barrës së provës.

5.4 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm:

Komisioni, duke pasur parasysh deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në Deklaratën për vitin 2003, provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të postës elektronike, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, arsyetoi se:

- (i) Subjekti ka kryer fshehje të destinacionit të kredisë. Veprimi i kryer nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e kredimarrëses është fiktiv, çka rëndon pozitën e subjektit të rivlerësimit, provuar kjo me:
- praktikën bankare, nga ku rezulton se kredia është disbursuar më 10 mars 2003;
 - deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, mbi disbursimin e kredisë pas blerjes së apartamentit;
 - kontratën nr. *** rep., *** kol., datë 01.10. 2007, sipas cilës pagesat e blerjes së kësaj pasurie janë kryer përkatësisht në vlerën 24 000 dollarë, shlyer në muajin janar 2003, dhe në vlerën 30 000 dollarë, shlyer në muajin shkurt 2003.

Komisionit nuk iu vu në dispozicion asnjë dokument ligjor (i llojit kontratë) për të provuar disbursimin e kredisë në shumën 40 000 dollarë (USD) për apartamentin e deklaruar nga subjekti

³³ Referojuni parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit në dosje.

i rivlerësimit dhe babai i saj, në deklaratat përkatëse të pasurisë për vitin 2003, në të cilat citohet “...për blerje të apartamentit në *katin e 6-të*”³⁴.

Komisioni nuk mund të marrë të mirëqenë deklaratën e bërë nga shoqëria ndërtimore “***” sh.p.k., nr. *** rep., ***kol., datë 05.04.2018, të nënshkruar gjatë hetimit administrativ, kur në fakt të njëjtat palë, kanë mbajtur një tjetër qëndrim në kontratë dhe për më tepër detajet e dhëna në deklaratë kanë qenë të mundura të pasqyroheshin në kontratën nr. *** rep., *** kol., datë 01.10. 2007.

Komisioni konstaton se në kontratën nr. *** rep*** kol., datë 01.10. 2007, nuk është pasqyruar mënyra e pagesës së blerjes për këtë apartament, me burim kredinë në vlerën 40 000 dollarë. Përkundrazi, në kontratë është pasqyruar “*Palët deklarojnë se me vlerën e shitblerjes janë likuiduar jashtë kësaj zyre, sipas dokumentacionit, me këstin e parë prej 30 000 dollarësh në datën 24 janar 2003 dhe këstin e dytë prej 24 450 dollarësh në datën 28 shkurt dhe nuk kanë asnjë pretendim ndaj njëri-tjetrit*”. Në kushtet kur kjo kontratë lidhej qëllimisht për blerjen e apartamentit me burim kredinë, palët nuk mund të nënshkruanin një akt noterial që nuk pasqyronte vërtetësinë e disbursimit të kredisë.

Nga korrespondenca me bankën, nga provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit pas pyetjeve të drejtuara, nuk provohet se për cilën pasuri është disbursuar kredia.

6. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për vitin 2003 ka deklaruar:

Tokë bujqësore, me sipërfaqe 666 m², në pjesë takuese ¼, në vlerë totale 500 000 lekë, në fshatin ***, komuna ***, me zë kadastral ***. Për këtë pronësi ka deklaruar si **burim krijimi** “*të ardhura familjare*”... dhe banesë karabina filluar ndërtimi në vitin 2000, në pjesë takuese ¼, me vlerë 3 milionë, në ***, “s’ka” nr. regjistrimi, **burim i deklaruar i krijimit** për ndërtimin e saj: “*të ardhura familjare nga shitja e banesës së përfutur nga privatizimi*” masiv në shumën 6 200 000 lekë.

6.1 Për të provuar faktin, Komisioni administroi:

- ✓ Shkresë nr. *** prot., datë 23.12.2017 drejtuar ILDKPKI-së, për dërgimin e deklaratave të pasurisë në emër të Z. S.Xh, për periudhën 2003 deri në 2006.
- ✓ ILDKPKI-ja, me shkresën e saj nr. *** prot., datë 28.12.2017, ka dërguar deklaratat e babait të subjektit të rivlerësimit.
- ✓ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.12.2017, i është kërkuar ZQRPP-së informacion, si dhe dokumentacion shoqërues mbi çdo pasuri të regjistruar në emër të personave të lidhur me subjektin e rivlerësimit, përkatësisht babait Z. S.Xh, nënës Znj. N.Xh dhe motrës Znj. A.Xh³⁵.

³⁴ Referojuni deklaratave përkatëse të pasurisë për vitin 2003 të plotësuara veçmas, nga subjekti i rivlerësimit dhe babai i saj, Z. S.Xh.

³⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 09.01.2018, ZVRPP *** konfirmon pasuri në emër të motrës së subjektit të rivlerësimit, Znj. A.Xh, me nr. ***, apartament me sipërfaqe 64.86 m², vol. ***, faqe ***, ndodhur në ZK ***.

Me shkresën nr. *** I prot., datë 11.01.2018, ZVRPP *** ka informuar se Z. S.Xh ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme pasuritë me të dhënat si më poshtë:

Pasuria nr. ***, vol. ***, faqe ***, ZK ***, lloji i pasurisë apartament me sipërfaqe 89.16 m² (pasuri e transkriptuar);

Pasuria nr. ***, vol. ***, faqe ***, ZK ***, lloji i pasurisë apartament me sipërfaqe 44.4 m² (pasuri aktive).
Znj.N.Xh ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme pasuritë me të dhënat si më poshtë:

Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit në këtë vit deklarimi ka qenë në të njëjtën përbërje familjare me prindërit e saj, babain S.Xh, nënën N.Xh, si dhe motrën e saj, A.Xh.

Nga provat e administruara rezultoi se truall me sipërfaqe 666 m² dhe shtëpia e ndërtuar mbi të, me adresë në fshatin ***, komuna ***, sipas certifikatës së pronësisë me nr. pasurie ***figuron në emër të nënës së subjektit të rivlerësimit, Znj. N.Xh.

6.2 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa më poshtë rezulton:

- a. Në Deklaratën “Vetting”, shtojca 2, nuk u gjend e deklaruar pasuria e përbërë prej ¼ pjesë takuese në truallin me sipërfaqe 666 m² në ***, komuna ***, si dhe godina e ndërtuar mbi të në të njëjtën pjesë takuese, siç edhe është deklaruar në deklaratat e pasurisë, respektivisht në vitin 2003 dhe 2004.

6.3 Subjekti i rivlerësimit, më datë 07.04.2018, dërgoi me anë të postës elektronike parashtrimet e saj³⁶ ku, ndër të tjera, për këtë pasuri është shprehur se:

- Duke qenë se familja kishte ekonomi të përbashkët dhe ishin të gjithë pjesëtarë madhorë dhe në marrëdhënie pune, si në çdo familje shqiptare kur jetohet me prindërit, ajo deklaronte të gjithë gjendjen pasurore financiare të familjarëve të saj në të njëjtën mënyrë sipas deklarimit të kryefamiljarit dhe e konsideronte veten të lidhur me ta, duke prezumuar ¼-tën si në të drejta, ashtu edhe detyrime.
- Duke qenë se ligji përdorte termin “të gjitha pasuritë e akumuluar”, subjekti i rivlerësimit deklaronte të gjithë pasurinë e familjarëve, pa specifikuar që këto kanë qenë të regjistruara në emër të prindërve.
- Ky deklarim është konsideruar korrekt nga ILDKPKI-ja, pasi subjekti i rivlerësimit figuronte në një trung familjar me personat e lidhur që kishin pasuri më vete, shkëputur nga familja e origjinës në vitin 2005.
- Nuk mund të deklaronte këtë pasuri për aq kohë sa nuk ka pasur dhe nuk ka titull pronësie mbi banesën ose mbi truallin në fjalë.

6.4 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet

Lidhur me deklaratimet e bëra për pasurinë “truall me sipërfaqe 666 m² në ***, komuna ***, si dhe godinën e ndërtuar mbi të, në të njëjtën pjesë takuese, në vitin 2003 dhe 2004”, si dhe shqyrtimit të dokumentacionit hipotekor, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit, ka bërë deklarim të pasaktë në raport me pjesën takuese me veprimet juridike.

Pasuria nr. ***, vol. ***, faqe ***, ZK ***, lloji i pasurisë apartament me sipërfaqe 89.16 m² (pasuri e transkriptuar).

Pasuria nr. ***, vol. ***, faqe ***, ZK ***, lloji i pasurisë truall me sipërfaqe 666 m² dhe ndërtesë me sip 112 m² (pasuri aktive).
Znj. A.Xh ka të regjistruara në regjistrin e pasurive të paluajtshme pasuritë me të dhënat si më poshtë:

Pasuria nr. ***, vol. ***, faqe ***, ZK ***, lloji i pasurisë apartament me sipërfaqe 89.16 m² (pasuri e transkriptuar);

Pasuria nr. ***, vol. ***, faqe ***, ZK ***, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 200 m² (pasuri aktive);

Pasuri me nr. ***, vol. ***, faqe ***, ZK ***, lloji i pasurisë apartament me sipërfaqe 111 m² (pasuri aktive).

³⁶ Referojuni parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit në dosje.

7. “Banesë karabina filluar ndërtimi në vitin 2000, në pjesë takuese ¼, me vlerë 3 milionë në *******, **me burim krijimi**: “*Shitja e apartamentin të përfituar nga privatizimi masiv i banesave shtetërore e ndodhur në Rr “***”, pll. *******, shk. *******, ap. *******, ******* nga babai i saj, Z. S.Xh, në vlerën 6 200 000 lekë”.*

35 000 dollarë të ardhura nga shitja e këtij apartamenti/ **Burimi i deklaruar i krijimit**: Nga shitja e banesës në Rr. “***”...përfituar nga privatizimi masiv.

7.1 Për të provuar faktin, Komisioni administroi:

- Në praktikën e ZVRPP-së Tiranë, nr. ******* prot., datë 29.12.2017, është administruar kontrata e shitjes nr. ******* rep., ******* kol., datë 10.11.2003, për apartamentin që i përket pasurisë nr. *******, Zona Kadastrale *******, me sipërfaqe 89.16 m², ndodhur në rrugën “***” pll. *******, shk. *******, ap. *******, Tiranë. Gjithashtu, në dosjen e përcjellë nga ZQRPP-ja është administruar edhe kontrata e shitjes nr. ******* rep., ******* kol., datë 08.02.2003.

Sipas këtij dokumentacioni, rezulton se Z. S.Xh. e ka blerë këtë apartament në shumën 1500 000 lekë nga familjarët e tij dhe e ka shitur atë në shumën 5 900 000 lekë.

7.2 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa më poshtë rezulton:

- Ka mospërputhje sa u takon vlerave të deklaruara në deklaratën e vitit 2003, dhe pjesës takuese me veprimet juridike ku subjekti i rivlerësimit ka qenë bashknënshkruese për sa më poshtë:
- Keni depozituar kontratën e shitjes së apartamentit të përfituar nga privatizimi i banesave shtetërore midis babait tuaj dhe të tretëve në shumën 5 900 000 lekë”;
- Në deklaratimet e dhëna keni deklaruar ¼ tuaj si pjesë takuese;
- Për këtë pasuri ka një tjetër veprim juridik tjetërsimi ku ju së bashku me katër bashkëpronarë të tjerë, me kontratën nr. ******* rep., ******* kol., datë 08.02.2003, i keni shitur më parë apartamentin e privatizuar me nr. pasurie *******, zonë kadastrale *******, me sipërfaqe totale 89.16 m², e ndodhur në Rr. “***”, pll. ******* shk. *******, ap. *******, Tiranë, babait tuaj, Z. S.Xh, në shumën 1 500 000 lekë, duke u zhveshur kështu nga pronësia e tij dhe përfituar nga 1/5-ta pjesë takuese në vlerë leku, konkretisht shumën 300 000 lekë.

7.3 Subjekti rivlerësimit, më datë 07.04.2018 dërgoi me anë të postës elektronike parashtrimet e saj³⁷ ku, ndër të tjera, për këtë pasuri është shprehur se:

- Ishte konsultuar me prindërit e saj, të cilët e kanë vënë në dispozicion të gjithë praktikën e privatizimit të apartamentit dhe arsyet përse është hartuar veprimi juridik i datës 08.02.2003, duke dhënë si argument shmangien e procesit gjyqësor.

Subjekti i rivlerësimit edhe në seancë dëgjimore u qëndroi parashtrimeve të depozituara pas kalimit të barrës së provës.

³⁷ Referojuni parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit në dosje.

7.4 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm:

Komisioni, mbështetur në deklarinimin periodik të vitit 2003 të subjektit të rivlerësimit, provat shkresore të administruara, sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, arsyeton se:

Për këtë pasuri subjekti i rivlerësimit, Znj. Altina Xhoxhaj, ka bërë deklarinim të rremë, provuar kjo me:

- Kontratën nr. *** rep., *** kol., datë 08.02.2003, sipas së cilës ka përfituar të ardhura në shumën 300 000 lekë.

- ✓ Bazuar në dokumentacion e ZVRPP-së Tiranë, vërehet se subjekti i rivlerësimit, së bashku me babanë, nënën, motrën dhe dy shtetas të afërm të familjes, kanë qenë bashkëpronarë të pasurisë me nr. *** , zonë kadastrale *** , e përbërë nga 3 dhoma dhe 1 kuzhinë, si dhe ambiente të tjera ndihmëse, me sipërfaqe totale 89.16 m², e ndodhur në Rr “***”, pll. 80, shk. *** , ap***, Tiranë, përfituar nga privatizimi i banesave shtetërore.
- ✓ Subjekti i rivlerësimit së bashku me bashkëpronarët e tjerë me kontratën nr. *** rep., *** kol., datë 08.02.2003, ia kanë shitur këtë apartament babait të saj, Z. S.Xh, në shumën 1 500 000 lekë, duke u zhveshur kështu nga pronësia dhe për pasojë duke përfituar 1/5-tën pjesë takuese në vlerë leku, konkretisht në shumën 300 000 lekë secili.
- ✓ Më tej, po në të njëjtin vit kalendarik (2003), sipas kontratës me nr. *** rep., *** kol., datë 10.11.2003, rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit, Z. S.Xh, ka shitur apartamentin e mësipërm, në shumën 5 900 000 lekë.
- ✓ Subjekti, në shpjegimet e saj anashkalon tërësisht shitjen e pasurisë përmes kontratës nr. *** rep., *** kol., datë 08.02.2003, sipas së cilës ka përfituar të ardhura në shumën 300 000 lekë, ndërsa Komisioni e siguroi vetë këtë akt nga praktika e ZVRPP-së Tiranë.
- ✓ Deklarimet e subjektit, se është konsultuar me të atin për të mësuar se përse është hartuar veprimi juridik i datës 08.02.2003, nuk gjejnë mbështetje për subjektin e rivlerësimit, pasi veprimi juridik është hartuar përpara noterit.

Në përfundim, Komisioni çmon se nuk përputhet deklarinimi i subjektit të rivlerësimit, me kontratën nr. *** rep., *** kol., datë 08.02.2003, për pasojë subjekti ka kryer deklarinim të rremë sa i përket vlerës së përfituar nga shitja e kësaj pasurie.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT PËR KONTROLLIN E FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 02.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Grupi i Punës ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit.

V. PROCESI I RIVLERËSIMIT TË KRITERIT ETIKO-PROFESIONAL

Vlerësimi i aftësive profesionale është bazuar në:

- Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Inspektorati i KLD-së, nr. ***prot., datë 05.12.2017.
- Informacionin e marrë nga burime të ligjshme.
- Kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

1. Sipas raportit të KLD-së ka rezultuar:

1.1 Në lidhje me aftësitë profesionale

a) Ka njohuri të gjera ligjore, identifikon normën kushtetuese të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj, njeh mirë çështjet procedurale në funksion të zgjidhjes së saktë të themelit të çështjes, në funksion të nxjerrjes së konkluzioneve, përdor referenca në jurisprudencën e vetë Gjykatës Kushtetuese apo edhe në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut;

b) Ka aftësi në drejtim të arsyetimit ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara janë të qarta, të kuptueshme, të organizuara sipas një metodologjie të caktuar me nënpjesë. Analizon çështjet procedurale, kryesisht elementet e legjitimitetit të kërkuarit dhe të juridiksionit kushtetues, respekton standardin e procesit të rregullt ligjor, fjalitë paraqiten të qarta dhe janë respektuar rregullat e drejtshkrimit. Format i vendimit është i unifikuar me atributet e vendimit të dhëna në fund të faqes.

c) Në lidhje me aftësitë organizative, subjekti është eficient dhe efektiv në punë. Nuk rezulton të ketë pasur ngarkesë të lartë të çështjeve. Është konstatuar se ka pasur raste mbi fillimin e shqyrtimit me vonesë të çështjes nga koha e paraqitjes së kërkesës. Është konstatuar se ka pasur raste të zgjatjes së afateve për gjykim. Është konstatuar se ka pasur raste të arsyetimit me vonesë të vendimit, duke mos u respektuar afatet ligjore.

1.2 Në lidhje me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale

- a) Subjekti ka reflektuar etikë në punë. Subjekti i rivlerësimit për periudhën prill 2010-aktualisht, ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese e emëruar nga Presidenti i Republikës, me pëlqimin e Kuvendit.
- b) Nuk ka të dhëna në lidhje me mungesën e integritetit.
- c) Nuk janë konstatuar raste që subjekti të ketë cenuar të drejtat e palëve, apo të ketë përdorur gjuhë diskriminuese.

1.3 Në lidhje me aftësitë personale dhe angazhimin profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Për shkak se çështjet janë shqyrtuar pa pjesëmarrjen e palëve apo edhe për shkak se komunikimi i drejtpërdrejtë në seancë plenare bëhet nga kryetari i gjykatës, për subjektin e rivlerësimit konstatohet se gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Konstatohet se bashkëveprimi me palët, anëtarët e trupit gjykues, administratën gjyqësore dhe institucionet e treta ka qenë në nivelin e duhur.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit i ka kushtuar rëndësi formimit akademik. Ajo ka gradën shkencore “Doktor në të drejtën civile tregtare”, ka kryer studime universitare, disa specializime, mban cilësinë e trajnueses, etj.

Për sa i përket raportit të KLD-së dhe dokumentacionit mbi të cilin është mbështetur përgatitja e tij, ndër të tjera është konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë pasur ngarkesë të lartë të çështjeve, ka pasur raste të arsyetimit me vonesë të vendimit, duke mos u respektuar afatet ligjore, ka pasur raste mbi fillimin e shqyrtimit me vonesë të çështjes nga koha e paraqitjes së kërkesës, si dhe raste të zgjatjes së afateve për gjykim.

Gjithashtu, KLD-ja me shkresën nr. ***prot., datë 21.02.2018, ka informuar se ndaj subjektit të rivlerësimit nuk është marrë ndonjë masë disiplinore kryesisht në periudhën që ka qenë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

VI. DENONCIME NGA PUBLIKU SIPAS NENIT 53 TË LIGJIT NR. 84/2016

1. Denoncimi

Bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni administroi një denoncim nga shtetasi V. Ç., nr. *** prot., datë 05.12.2017, i cili denonconte mosveprime të kryera nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me mosdeklarimin e konfliktit të interesit në lidhje me një çështje gjyqësore, vendimi nr. 46, datë 03.03.2016, shqyrtuar pranë Gjykatës Kushtetuese, ku subjekti i rivlerësimit është me funksion gjyqtar.

Mosdeklarimi i konfliktit të interesit lidhet me një çështje gjyqësore, vendimi penal nr. ***, datë 09.09.2011, i Gjykatës së Apelit Tiranë, ku babai i subjektit të rivlerësimit ka qenë relator dhe subjekti i rivlerësimit në pozicionin e gjyqtarit me mendim pakice (vendimi nr. ***, datë 03.03.2016 i Gjykatës Kushtetuese), gjykim nga i cili subjekti i rivlerësimit duhet të kishte hequr dorë, bazuar kjo në nenin 36/ç të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndyshuar, i cili parashikon se: “Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese kërkon heqjen dorë nga shqyrtimi i një çështjeje konkrete kur (shkronja “ç”) paanshmëria e tij vihet në dyshim për shkaqe të tjera...”.

2. Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa më lart rezulton.
3. **Subjekti i rivlerësimit, më datë 07.04.2018 dërgoi me anë të postës elektronike parashtrimet e saj³⁸ ku, ndër të tjera, për këtë pasuri është shprehur se:**
 - Procesi gjyqësor ku ka marrë pjesë në trupin gjykues babai i saj, i referohet një procesi tërësisht të ndryshëm nga ai i kundërshtuar nga denoncuesi V. Ç. në Gjykatën Kushtetuese, pasi babai i saj e ka shqyrtuar këtë çështje në lidhje me zbatimin e institutit të parashkrimit të ndjekjes penale, pretendim i ngritur në ankim, dhe nuk ka shqyrtuar apo shprehur në lidhje me elementet e veprës penale dhe nëse ajo ishte kryer nga të pandehurit.

4. Arsyetimi ligjor bazuar në ligjin e zbatueshëm

Komisioni, mbështetur në deklaratimet e denoncuesit; dosjen nga Gjykata Kushtetuese; në ligjin e aplikueshëm, shkresën e ardhur nga ana e KLD-së, si dhe shpjegimet nga subjekti i rivlerësimit dhe avokatja e saj për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, arsyeton se:

Subjekti i rivlerësimit, me anë të mosveprimit të saj, duke mos hequr dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje, në kundërshtim me nenin 36/ç të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, provuar kjo me:

- përgjigjen e dërguar nga ana e KLD-së me nr. *** prot., datë 12.04.2018, e vlerëson kërkesën si rast që përbën shkak për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit, i cili duket se ka qenë në kushtet e papajtueshmërisë me ushtrimin e detyrës ose në kushtet e heqjes dorë në bazë të nenit 72/6 të Kodit të Procedurës Civile. Për shkak të mospasjes kompetencë për të nisur këtë procedurë, KLD sugjeron adresimin e rastit pranë kryetarit të Gjykatës Kushtetuese ku subjekti ushtron veprimtarinë, bazuar në nenin 10/a të ligjit nr. 99/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.
- mendimin e pakicës të përgatitur nga ana e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë çështje, duke mbajtur kështu të njëjtën linjë me atë çfarë është vendosur në Gjykatën e Apelit.

Për më tepër, Komisioni, konkluzionin se subjekti i rivlerësimit duhet të kishte hequr dorë, e mbështetet në:

- (i) Vendimin penal nr. 21/2010 të Gjykatës Kushtetuese, në të cilin, ndër të tjera, arsyetohet se *“Parimi i paanshmërisë në gjykim, në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit...”*. Gjykata ka theksuar se: *“...thjesht dhe vetëm pjesëmarrja e një apo më shumë gjyqtarëve në një procedim të mëparshëm, pavarësisht nga ndikimi i prezencës dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjykues, është një arsye e mjaftueshme dhe njëkohësisht një garanci më pak për*

³⁸ Referojuni parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit në dosje.

kërkuesin, tek i cili është krijuar dyshimi i bazuar, se gjykata nuk ka qenë e paanshme në shqyrtimin e kësaj çështjeje”;

- (ii) Mendimin e pakicës të vendimit penal nr. 70/2015 të Gjykatës Kushtetuese, arsyetuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, në të cilin citohet shprehimisht: *“Parimi i paanshmërisë së gjyqtarit/gjykatës është një nga elementet kryesore të së drejtës për një proces të rregullt. Neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së kërkojnë që një gjykatë brenda juridiksionit të saj të jetë e paanshme, ku paanshmëri do të thotë mungesë paragjykimi apo anësie, dhe ekzistenca e saj mund të provohet në mënyra të ndryshme”.*

Për të arritur në përfundimin nëse ky pretendim është i bazuar, Gjykata ia nënshtron atë dy testeve, konkretisht testit subjektiv, si edhe testit objektiv... Për sa i përket testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta, kurse për sa i përket atij objektiv, ai kërkon fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë.

VII. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Znj. Altina Xhoxhaj ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Nuk është konstatuar e njëjta gjë për dokumentacionin e kërkuar nga Komisioni për kërkesa specifike, të cilat kanë mbetur në kuadër deklarativ.

VIII. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për vlerësimin e pasurisë dhe denoncimet nga publiku, sipas nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, konkludohet se:

a. Për vlerësimin e pasurisë,

- (i) Për pasurinë 1, apartament banimi me sipërfaqe 101 m²..., nuk ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes të vitit 2005; nuk ka të ardhura të mjaftueshme për blerjen e pasurisë në vitin 2003, burim krijimi i pasurisë-vetting; ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; ka kryer deklarim të rremë mbi të ardhurat për të justifikuar këtë pasuri, si të krijuar nga burime të ligjshme, pasi ka përfituar dhe kaluar të drejta reale pronësie, sipas kontratës së nënshkruar në vitin 2003 dhe 2005, për pasojë ka fshehur interesin e saj pasuror me personin e lidhur.
- (ii) Për pasurinë 2, apartament 2 + 1 + verandë, me sipërfaqe 58.75 m², nuk ka të ardhura të mjaftueshme për blerjen e saj në vitin 2010.
- (iii) Për pasurinë 3, truall me sipërfaqe 221.9 m², ka përfituar sipërfaqe të tepërt trualli, veprim i cili rëndon pozitën e subjektit të rivlerësimit.
- (iv) Për pasurinë 4, likuiditete, ka mungesë të burimit financiar, për të justifikuar likuiditetet në vitin 2007, 2009 dhe vitin 2015, për pasojë ka kryer deklarim të rremë.

- (v) Për veprimin e kryer me pasurinë 5, ka kryer fshehje të destinacionit të kredisë. Veprimi i kryer në cilësinë e kredimarrëses është fiktiv, çka rëndon pozitën e subjektit të rivlerësimit.
- (vi) Për deklarin lidhur me pasurinë 6, ka bërë deklarin të pasaktë.
- (vii) Për deklarin lidhur me pasurinë 7, ka kryer deklarin të rremë.

b. Për denoncimin nga publiku, Komisioni gjykon se sjellja e subjektit të rivlerësimit, duke mos ndërmarrë veprimin ligjor lidhur me deklarin e konfliktit të interesit në vendimin nr. 46, datë 03.03.2016, të Gjykatës Kushtetuese (shih më lart), nuk arrijnë nivel të besueshëm për subjektin e rivlerësimit, duke cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

Në këto kushte, Komisioni, bazuar në provat që disponon, vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, vendosi me shumicë votash, që subjektit të rivlerësimit, Znj. Altina Xhoxhaj, gjyqtare pranë Gjykatës Kushtetuese, t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Trupa gjyquese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenet 179/b, D dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “c” të ligjit nr. 84/2016, pikës 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Znj. Altina Xhoxhaj, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës Kushtetuese.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të kësaj seance dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Apelimeve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

ETLEDA ÇIFTJA
Kryesues

GENTA TAFA (BUNGO)
Anëtar
Kundër

BRUNILDA BEKTESHI
Relator

Sekretare gjyqësore
Anisa Duka

Ishqiptaria.com

MENDIM PAKICE

Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën, në lidhje me procesin e rivlerësimit të subjektit Altina Xhoxhaj, anëtare e Gjykatës Kushtetuese, vlerësoj që të paraqes argumentet dhe arsyetimin për qëndrimin tim, si anëtare e trupës gjyquese e mbetur në pakicë, për këto çështje:

I. Në lidhje me pasurinë e paluajtshme, Apartament banimi me sipërfaqe 101 m², Rr. “*”, Nd. ***, H. ***, Ap ***, Tiranë**

Ndryshe nga sa argumenton shumica, unë vlerësoj se mospërputhja midis deklaratave të pasurive mund të përdoret si provë në bazë të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, por kjo provë nuk është e mjaftueshme për vlerësimin e subjektit sipas nenit 61/3 apo 61/5 të po këtij ligji. Pasaktësia në deklaram nuk mund të konsiderohet si deklaram i pamjaftueshëm për subjektin në këndvështrim të pikës 3 të nenit 61, për më tepër të pikës 5 të po këtij neni të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti i lidhur ka deklaruar në vitin 2005 (në cilësinë e subjektit deklarues për shkak të detyrës) se *“kjo pronë e ka burimin nga të ardhurat e fituara nga shitja e apartamentit të banimit të mëparshëm (56 000 euro) më datë 7 mars 2005, një ditë më parë blerjes së pasurisë objekt shqyrtimi (blerë në shumën 61 050 euro), më datë 8 mars 2005”*.

Ndërsa në Deklaratën “Vetting” është deklaruar se kjo pasuri e ka burimin e të ardhurave *“Nga puna dhe bursat e personit të lidhur, në Itali, nga viti 1992 deri në 2001”*.

Ndërkohë që përgjigjja e DPPP-së konfirmon si burim të ardhurat nga puna.

Nga analiza e këtyre deklarimeve konstatohet se apartamenti prej 101 m² është blerë me të ardhurat nga shitja e apartamentit të mëparshëm, ndërkohë që ky i fundit është deklaruar si i blerë me të ardhurat nga bursa dhe puna në Itali. Pra, në fund të fundit, origjina e të ardhurave për këtë apartament janë pikërisht këto të ardhura, pavarësisht krijimit dhe prishjes së një marrëdhënieje juridike të ndërmjetme. Në këto kushte, nuk gjykoj se kemi mospërputhje midis deklarimeve të viteve të ndryshme.

Në lidhje me të ardhurat nga bursa dhe puna në Itali, vlerësoj se dokumentacioni i kërkuar i përket një periudhe 20-23 vjet më parë. Është më se e kuptueshme pamundësia objektive e subjektit për vërtetimin me anë të dokumenteve të këtyre të ardhurave. Nga ana tjetër, lidhur me analizën financiare të kryer nga ana e Komisionit, çmoj se duhet të llogaritej edhe pjesa tjetër e bursës për pjesën e mbetur të vitit të fundit të shkollimit (janar-korrik 1995), sepse bursat, duke u akorduar për vitin shkollor, nuk mund të mos jetë lëvruar edhe për këtë periudhë, pavarësisht mungesës së dokumentacionit provues vetëm për këtë periudhë.

Për sa u përket të ardhurave nga puna në Itali, të personit të lidhur të subjektit, vlerësoj se analiza financiare paraqet probleme, duke qenë se për vitet 1996, 1998, 1999 merr në konsideratë

shpenzimet, por nuk merr në konsideratë asnjë të ardhur të deklaruar nga subjekti. Është fakt i njohur botërisht që studentët shqiptarë në Itali apo gjetkë, për më tepër në atë periudhë, kanë punuar në punë të ndryshme me qëllim sigurimin e të ardhurave shtesë, përtej bursave. Është fakt i njohur botërisht që kjo punë e studentëve është kryer “në të zezë”.

Sigurisht që ndryshimet e legjislacionit shqiptar konsiderojnë si të ardhura të ligjshme vetëm ato për të cilat është paguar tatimi përkatës, por fryma e ligjit nr. 84/2016 dhe, në mënyrë të veçantë, e Aneksit të Kushtetutës, nuk është frustruese, ajo favorizon subjektet duke legjitimuar deri në dyfishin e pasurisë së ligjshme. Ndërsa në këtë rast nuk bëhet fjalë për një masë të tillë të ardhurash.

Në lidhje po me këtë pasuri, ndryshe nga sa arsyeton shumica, unë vlerësoj se nënshkrimi i kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.03.2003, nga ana e subjektit, nuk e bën atë automatikisht pronar të pasurisë së paluajtshme apo të ardhurave që burojnë si pasojë e prishjes së kësaj kontrate. Pronësia mbi një pasuri të paluajtshme vërtetohet nga certifikata e pronësisë, sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe në këtë rast, një pasojë e tillë nuk ka ardhur. Nga ana tjetër, nuk ka asnjë gjurmë të përfitimit të një pjese të të ardhurave nga prishja e kontratës së sipërmarrjes nga ana e subjektit të rivlerësimit, por është administruar si provë e vetme deklarata e personit të lidhur me subjektin, që deklaronte pagimin fillestar të kësaj shume, si dhe kthimin mbrapsht të saj. Përderisa Komisioni nuk ka arritur të sigurojë asnjë provë dokumentare të kontributit të subjektit apo përfitimit prej tij në blerjen dhe shitjen e kësaj prone, çmuj se gjykimi dhe vlerësimi duhet të mbështetet vetëm në provat që janë në dispozicion, bazuar në nenin 51 të ligjit nr. 84/2016, dhe në këtë rast si provë e vetme mbetet vetëm deklarimi i subjektit dhe personit të lidhur me të.

Në vijim nuk mund të pajtohem me mendimin e shumicës kur arsyeton se “të ardhurat nga bursat janë akorduar për një qëllim të caktuar dhe për këtë shkak nuk mund të vlerësohen si burime të bindshme për të krijuar të ardhura për justifikimin e kësaj pasurie”. Askush nuk mund të paragjykohet për nivelin e jetesës, përderisa ky nivel nuk tejkalon nivelin e të ardhurave.

Në përfundim të këtij arsytimi vlerësoj se këto fakte duhet të merren parasysh në vlerësim në lidhje me apartamentin 101 m².

II. Pasuri e paluajtshme, apartament 2 + 1 + verandë, sipërfaqe totale 58.75 m², në pjesë takuese 50%, komuna * , për një vlerë totale 5 100 000 lekë, shlyer pjesërisht me pjesë nga të ardhurat nga kursimet ndër vite.**

Shumica, pas analizës financiare të subjektit, konstaton se nuk ka të ardhura të mjaftueshme në vlerën 450 000 lekë (2 250 000-1 800 000), për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2010.

Duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit dhe në frymën e Kushtetutës e Aneksit të saj, vlerësoj se kjo shumë nuk mund të çojë në shkarkimin e subjektit sipas pikave 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

III. Në Deklaratën e Pasurisë “Vetting”, ka deklaruar: *Truall me sipërfaqe 221.9 m²* (kalim i të drejtës së pronësisë mbi truallin e njësisë së ndërtuar), në pjesë takuese 50%, me adresë komuna *******, Durrës.

Në lidhje me këtë rezultat të hetimit, unë kam disa rezerva. Subjekti i rivlerësimit ka aplikuar pranë ALUIZNI-t, në vitin 2013, në përputhje me sipërfaqen e apartamentit që kishte në pronësi. Ky është veprimi ku subjekti shfaq vullnetin e tij dhe më pas vepron në përputhje me kërkesat e institucionit publik. Fakti që nga përllogaritjet e ALUIZNI -t në vitin 2018, pra 5 vjet më vonë, rezulton se subjekti duhej të përfitonte një sipërfaqe më të vogël, nuk mund të ngarkojë me faj subjektin. Për më tepër që në lidhje me këtë veprim nuk ka pasur pretendime as shoqëria ndërtuese e apartamentit, as fqinjët dhe askush tjetër. Subjekti ka zbatuar udhëzimet dhe kërkesat e institucionit kompetent, ALUIZNI-t, dhe në të gjithë dokumentacionin e administruar nuk vlerësoj se ka kryer shkelje të ligjit, apo cenim të figurës, siç pretendon shumica.

IV. Likuiditetet

Në lidhje me likuiditetet, shumica ka arsyetuar se subjekti ka mungesë të burimit financiar për të justifikuar shumën prej 450 097 lekësh në vitin 2007, shumën 965 119 lekësh në vitin 2009 dhe shumën 100 631 në vitin 2015, si dhe ka kryer deklaram të rremë lidhur me burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave.

Ndryshe nga sa gjykon shumica, vlerësoj se pasaktësitë në plotësimin e deklaratave të pasurisë nuk mund të konsiderohen si deklaram i rremë, apo mungesë burimesh të ligjshme. Këtë vlerësim e bazoj edhe në masën e të ardhurave të munguara nga llogaritjet e analizës financiare.

V. Gjatë hetimit kryesisht u konstatua kredimarrje e përfituar nga ana e subjektit të rivlerësimit në vitin 2003, për apartament 120 m², në shumën 40 000 USD.

Shumica ka vlerësuar si fakt, për të cilin i ka kaluar barrën e provës subjektit, mospërputhjen në kohë midis datës së marrjes së kredisë bankare, datës së shlyerjes së pagesës për apartamentin dhe datës së lidhjes së kontratës së shitblerjes. Nisur nga ky fakt, shumica arsyeton për një veprim fiktiv nga ana e kredimarrëses.

Ndryshe nga ky arsyetim, duke shqyrtuar dokumentacionin e grumbulluar nga hetimi administrativ, si dhe deklaramet e vetë subjektit, konstatoj se shumica e kredisë së përfituar është lëvruar drejtpërdrejt në llogarinë e shoqërisë ndërtuese, duke mos kaluar as në duart dhe as në llogarinë bankare të subjektit apo personave të lidhur me të. Ky fakt është i mjaftueshëm dhe bindës se kredia është marrë pikërisht për blerjen e këtij apartamenti dhe nuk mund të fajësohet subjekti për gabime materiale në kontratën e hartuar nga noteri publik, aq më tepër kur është fakt i njohur botërisht se gabimet materiale janë kthyer në një gjë rutinë të akteve të redaktuara nga noterët, por edhe në vendime gjyqësore.

Në lidhje me këtë argument të shumicës, unë vlerësoj se subjekti ka qenë korrekt në deklaratimet dhe veprimet e tij për procedurat e kësaj kredie bankare.

VI. Lidhur me denoncimin e bërë nga shtetasi V. Ç. për konflikt interesi në gjykimin kushtetues të subjektit, ndryshe nga sa arsyeton shumica, vlerësoj se subjekti ka qenë i saktë në deklaratimet dhe parashtrimet e tij për këtë rezultat të hetimit.

Me cilësinë e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, subjekti ka shprehur mendimin e tij në një proces kushtetues, që nuk ka aspak lidhje me procesin civil, në të cilin është shprehur personi i lidhur me të, babai i subjektit, si gjyqtar në Gjykatën e Apelit.

Në këto kushte, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit, Znj. Altina Xhoxhaj, nuk ka gjykuar në kushtet e ekzistencës së konfliktit të interesit.

Në lidhje me rezultatet e tjera të hetimit bashkohem me argumentimin e shumicës dhe në përfundim konkludoj ndryshe nga kjo shumicë. Bashkohem me mendimin e shumicës në lidhje me pasaktësi në deklarime apo mungesë të të ardhurave në momente të caktuara në lidhje me veprime juridike të caktuara, por duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, çmoj se subjekti i rivlerësimit, Znj. Altina Xhoxhaj, ka arritur një nivel të besueshëm të pasurisë, duke pasur në bashkëpronësi me personat e lidhur pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, në përputhje me të ardhurat e siguruara nga ajo vetë dhe personi i lidhur.

Subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe për këtë fakt nuk ka pretendime as nga shumica.

Subjekti i rivlerësimit arrin nivelin e duhur të vlerësimit të aftësive profesionale dhe kjo provohet jo vetëm me angazhimin e saj profesional, si gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese apo si lektore në Shkollën e Magjistraturës, por edhe nga aktiviteti shkencor i saj.

Komisionere

Genta Tafa (Bungo)